

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7336 E shtunë 28 Tetor 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion

Ditës

Inderuar kryetar i Bashkisë Tropojë, z. Besnik Dusha! Të dashur familjarë të pishtarit të demokracisë, Azem Hajdari! Të nderuar bashkëkombës ...
Vijon në faqen 14

Nga ILIR META

Të gjithë së bashku, për të përmbushur ëndrrën e Azemit



Opinion

Ditës

Në qoftë se Europa do të kishte një Nemër emblematik si dëshmi e gjallë e jetës, dijes dhe përvojës me drejtësi, ky do të ishte pa asnjë mëdyshje vetë presidenti ...
Vijon në faqen 22

Nga ARIAN GALDINI

Gianni, Shqipëria nuk është e zhytur, por e mbytur!



Qeveria miraton paketën fiskale, ndryshimet

"Taksë 0.05% për 110 mijë shtëpi në proces legalizimi"

Ministri i Financave: Ja sa do të paguani për ndërtimet para vitit 1993. Taksa mbi pronën, caktohet masa për bizneset

Nga ORNELA MANJANI

Rreth 110 mijë ndërtime pa leje që janë në proces legalizimi do të përfshihen në skemën e taksës e mbi pronën nga 1 janari i vitit të ardhshëm. Taksa do të jetë 0.05% e vlerës së tregut të ndërtimit. ...
Në faqen 4

LISTA E PLOTE ME EMRAT E TRASHËGIMTAREVE QË MARRIN DEMSHPERBLIMIN

ISH-TE PERNDJEKURIT, 840 PERFITUESIT E KESTIT TE II

Ministria e Financave: Fëmijët dhe nipërit e ish-të dënuarve, dokumentet dhe afatet që duhet të paraqesin në drejtorinë e pagesave për të marrë paratë.



(Në foto) Ish-të perndjekur gjatë një proteste

FTESA NE PROKURORI

PPE: Rama, mos bëj presion për Tahirin, dëshmia e ish-ministrit

Në faqen 5

DEBATI PER AKADEMINE

Gudar Beqiraj: Njohja ime me Ilir Metën dhe e vërteta e pritjes së dekretimit

Në faqen 11

AKADEMIKU

Fuga: Fyerjet ndaj gazetarëve, zhvendosje e vëmendjes, harxhim kohe pa rendiment

Në faqen 8

HISTORIA NE GJYKATE

'Lufta' për kujdestari, Ermira: Burri më dhunonte, kam 4 vjet pa folur me fëmijën

Në faqen 9

INTERVISTA NDRYSHE E KRYEMINISTRIT



Edi Rama: Çfarë i thashë Tahirrit për "Audin" A8 që ua shiti Habilajve

Në faqen 3



Zbulohet jeta e mëparshme e partnerit të Zajmina Vasjarit. Rrëfëhet Xheni Bushi

Oni Hysenbelliu, jeta e pasionet e biznesmenit

Plani për të sjell seks simbolin Pamela Anderson në Shqipëri

Fatmir Hysenbelliu është një ndër biznesmenët më të rinj në Shqipëri. Edhe pse 25 vjeç ai është shumë i suksesshëm, kjo edhe falë bizneseve që babai i tij ka ndërtuar në vite. Fatmiri, ose siç njihet ndryshe Oni është bërë mjaft i njohur edhe në rrjetet sociale, pasi aty tregon



projektet e tij, por edhe jetën luksoze që bën. Të jetuarit mes luksit i ka mundësuar atij të udhëtojë e të njohë botën, por jo vetëm kaq. Oni ka takuar personazhe të njohur, si Pamela Anderson apo Nicole Scherzinger. Madje në portale kanë ...
Suplement

Suplement

HEROI I DEMOKRACISE CEREMONIA

LSI, në ceremoninë e inaugurimit të shtatores, Azem Hajdari "rikthehet" në shtëpi

Valentina Madani

Një përmendore e derdhur në bronz nga bashkëkombësit e tij. Njëra nga të shumtat në mbarë vendin. Azem Hajdari dhe "rikthye" në vendlindje, në qytetin e Bajram Currit. Vendosija e shtatores prej bronzi të Azem Hajdarit në qendër të qytetit u shndërrua në një ditë feste për tropojanët dhe për opozitën, drejtuesit kryesorë të së cilës morën pjesë në ceremoninë e organizuar nga Bashkia demokratike e Tropojës. Përrurimi i shtatores së Azem Hajdarit ishte një rast për të treguar afërsimin mes faktorëve opozitarë, kur Lulzim Basha, Monika Kryemadhi dhe Sali Berisha qëndruan së bashku gjatë ceremonisë. Presidenti i Republikës, Ilir Meta përshëndeti përrurimin e shtatores së udhëheqësit të Lëvizjes Studentore Shqiptare të Dhjetorit 1991, Heroit të Demokracisë dhe ish-deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, Azem Hajdari në Tropojë. Mesazhi i presidentit u përcoll të pranishmëve të shumtë në ceremoninë e përrurimit të shtatores, që u zhvillua në qendrën e qytetit të Bajram Currit, nga këshilltari ushtarak i tij, gjeneral brigada, Piro Ahmetaj.

DONATORËT

Vendosija e skulpturës u bë pikërisht në sheshin me të njëjtin emër, "Azem Hajdari", i cili përbën një nga zonat me të frekuentuara në qytetin e Bajram Currit. Sipërfaqja e sheshit është rreth 6000 m² dhe duke pasur parasysh formën e rregullt të tij, skulptura u vendos në aksin e këtij sheshi me fityrë nga Mali i Shkëlzenit. Shtatorja ka një lartësi rreth 5 m, pa llogaritur bazamentin. Kjo shtatore është një ndërims për rolin e tij, në shërbim të demokracisë shqiptare dhe për krenari të Azem Hajdarit përfaqësor. Janë 73 kontribues për ngritjen e shtatores së ish-liderit të dhjetorit. Mes tyre, edhe Partia Demokratike, e cila është edhe një nga iniciatorët e këtij projekti. Roli i rëndësishëm i kësaj partie duket edhe në kontributin e saj, i cili është më i madhderi tani, me 20 mijë euro.

CEREMONIA

Në përrurimin e shtatores morën pjesë personalitete të larta shtetërore, politike e kulturore nga Shqipëria, Kosova, Maqedonia, Mali i Zi, Kamëria, Lugina e Preshevës dhe diasporat shqiptare në Amerikë e në Europë. Në ceremoni ishin familjarët e ish-presidentit kosovar Ibrahim Rugovës, familjes Jashari dhe Haradinaj. Isa Baliaj është autori i kësaj përmendoreje, inaugurimi i së cilës veç tropojanëve, solli nga Tirana jo vetëm familjarët, por edhe deputetë, zyrtarë më të lartë

Tropoja i ngre përmendore Azenit, Basha: Liria fitohet me betejë

Emrat e donatorëve për ngritjen e shtatores



AUTORI

Isa Baliaj është autori i përmendores, inaugurimi i së cilës veç tropojanëve, solli nga Tirana jo vetëm familjarët, por edhe deputetë, zyrtarë më të lartë demokratë, kryerepublikanin Fatmir Mediu, Princin Leka, madje edhe kryetaren e LSI-së, Monika Kryemadhi.

Shtatorja e Azem Hajdarit në qytetin e Bajram Currit



SPONSORIZUESIT E REALIZIMIT TË SHTATORES SË AZEM HAJDARIT

1. BASHKIA TROPOJË	16,000,000 Lekë
2. PARTIA DEMOKRATIKE E SHQIPËRISË	10,000 Euro
3. Harry Bajraktari, NY, USA	8,000 USD
4. Rrustem Geci, NY, USA	8,000 USD
5. Faik Curri	5,000 Euro
6. Fatmir Meta	5,000 Euro
7. Myftar Lumeshi	5,000 Euro
8. Vëllezërit Biçiçi, NY, USA	500,000 Lekë
9. PE-VLA-KU shpk, Vladimir Gjoka dhe Kujtim Arifi	500,000 Lekë
10. Hotel Turizim Shkëlzeni, Petrit Imeri	300,000 Lekë
11. Ujë "Lajthiza", Hajri Elezi	2,000 Euro
12. Bajram Rusi	2,000 Euro
13. Bujar Leska	2,000 Euro
14. Sali Hajdari	2,000 USD
15. TRANSOIL GROUP sha Shefqet Dizdari	2,000 USD
16. Xhafer Gecaj	2,000 USD
17. Ramë Ali Selimaj, Angli	1,000 GBP
18. Besnik Dushaj	1,000 Euro
19. Bujar Vukaj	1,000 Euro
20. Dashamir Tahiri	1,000 Euro
21. Erzen Bregani	1,000 Euro
22. Hyreni Musa	1,000 Euro
23. Perlat Goci	1,000 Euro
24. Rasim Hasanaj	1,000 Euro
25. Rifat Dushaj	1,000 Euro
26. Skënder Gjoni	1,000 Euro
27. Shoqata Humanitare "Sali Çekaj", Zvicër	1,000 Euro
28. Shpresa Bregani	1,000 Euro
29. Agata & Orlan Misha, NY, USA	1,000 USD
30. Agim Rexhaj, NY, USA	1,000 USD
31. Besnik dhe Agron Zherka, NY, USA	1,000 USD
32. Fritim Baliaj, NY, USA	1,000 USD
33. Hasan Ademaj, NY, USA	1,000 USD
34. Mustafa Elezi, NY, USA	1,000 USD
35. Visar Demushi, NY, USA	1,000 USD
36. Yiber Dauti, NY, USA	1,000 USD
37. Zeqir Hasan Ramaj, NY, USA	1,000 USD
38. Isai Çela	100,000 Lekë
39. Nuredin Seci	600 USD
40. Arjan Bytyk bashi	500 Euro
41. Anton Raja, NY, USA	500 USD
42. Arben Vatsoi, NY, USA	500 USD
43. Binak Hysenaj	500 USD
44. Elmi Berisha, NY, USA	500 USD
45. Fadi Berisha, NY, USA	500 USD
46. Fari Metaliaj, NY, USA	500 USD
47. Feriz dhe Teuta Lama	500 USD
48. Gani Hysenaj	500 USD
49. Halit Neza, NY, USA	500 USD
50. Hamdi Neza, NY, USA	500 USD
51. Hasan Rudolfo Hysenaj	500 USD
52. Isa Bria, NY, USA	500 USD
53. Lu Lu, NY, USA	500 USD
54. Luigj Gjellaj, NY, USA	500 USD
55. Martin Shkrolli, NY, USA	500 USD
56. Milazim Berisha, NY, USA	500 USD
57. Muharem Elezi, NY, USA	500 USD
58. Rrustem Hysenaj	500 USD
59. Sejdi Hyseni, NY, USA	500 USD
60. Sherif Neza, NY, USA	500 USD
61. Zahir Veljaka (Semi), NY, USA	500 USD
62. Erenik Zenezi, NY, USA	250 USD
63. Gjok Deckaj, NY, USA	250 USD
64. Roland Zenezi, NY, USA	250 USD
65. Afrim Metaliaj, NY, USA	200 USD
66. Dalip Geca, NY, USA	200 USD
67. Halil Mula, NY, USA	200 USD
68. Musli Mulocmani, NY, USA	200 USD
69. Arber Rasim Hasanaj	100 Euro
70. Sidorela Sali Hajdari	100 Euro
71. Ahmet Rexhepi, NY, USA	100 USD
72. Gani Haxhia, NY, USA	100 USD
73. Gjon Bucaj, NY, USA	100 USD

Berisha: Velloja e zezë ka mbuluar Shqipërinë

Nga Tropoja ku mori pjesë në ceremoninë e vendosjes së shtatores së Azem Hajdarit, lideri i demokracisë, Sali Berisha bëri një apel në adresë të shqiptarëve, duke i ftuar të frymëzohen nga shembulli i Heroit të Demokracisë, përpara rrezikut që sipas tij po i kanoset vendit. "Nuk mund të mos mohojmë se një vello e zezë ka mbuluar Shqipërinë dhe kjo vello e zezë është velloja e narkotikëve. Jemi këtu, më të vendosur se kurrë, të frymëzuar nga Azem Hajdari për t'u ndarë edhe nga kjo e keqe, për t'u ndarë nga çdo e keqe që nuk meritohet, për të ecur të sigurt drejt hapësirave europiane që ne meritohet", deklaroi z.Berisha. Ai tha se Shqipërinë e ka mbuluar velloja e zezë e narkotikëve dhe se shqiptarët duhet të luftojnë të bëjnë realitet ëndrrën e Azem Hajdarit për të ecur drejt hapësirave europiane. Sipas tij, Azem Hajdari është bir i shquar, që u ngrit si luan për të ndarë shqiptarët nga diktatura. "Bir i shquar, që do ngrihej si luan për të ndarë shqiptarët nga diktatura, me motivin 'E duam Shqipërinë si gjithë Evropa'. Azem Hajdari jeton dhe do jetojë për jetën ideale të rinisë, në ëndërrën më të bukur të çdo qytetari të kësaj toke, që do të ndjehet i barabartë, i lirë, me dinjtet, me kokën lart. Ndaj dhe sot ai është frymëzim, sepse dhe sot pas 27 vitesh nuk mund të mohojmë se një vello e zezë ka mbuluar Shqipërinë, velloja e zezë e narkotikëve, që bën që shqiptarët të mos marrin dot fatin e tyre, të mos vendosin dot për votën e tyre"-tha Berisha.

demokratë, kryerepublikanin Fatmir Mediu, Princin Leka, madje dhe kryetaren e LSI-së, Monika Kryemadhi. Ceremoninë e hapi me fjalën e tij, kryebashkiaku i Tropojës, Besnik Dushaj. "Djalni tonë të bukur e përcollmë të ri, - tha Dusha - dhe na u kthye në bronz. Azem, ti je gjallë dhe falemdinderit që na dha mundësitë të ëndërronjme!".

MESAZHI

Kreu demokrat, Lulzim Basha, e quajti këtë si ditën e rikthimit të përjetshëm të Azem Hajdarit në vendlindjen e tij. "Tropojës i takon nderi i këtyre kënaq lëvizjeve historike, që hapi epokën e demokracisë europiane në Shqipëri edhe liderin e Stue-

Kryemadhi: Rama ndjehet i "fortë" prej bandave

Kryetarja e LSI, Monika Kryemadhi, ishte e pranishme dhe në Tropojë për përrurimin e shtatores së Azem Hajdarit. Ajo kritikoi kryeministrin Rama: "Përpjekja e kryeministrit në detyrë për të marrë protagonizmin gjatë ceremonisë së inaugurimit të shtatores së Azem Hajdarit, për të qenë 'live' në ato media që i shan dhe i fyen pa limit, është tregues i qartë i frikës dhe pasigurisë. Sepse sado pushtet dhe mbështetje të kesh nga bandat, nuk arrin kurrë të jesh i guximshëm për t'u përballur me të vërtetën e dhimbshme të një pushteti në rrënim. Sado 'i fortë' të ndihesh nga banditët që të rrethojnë, nuk do mundesh kurrë të krahasosh me ata që guxim dhe formimin politik nuk e vunë kurrë në përdorim të së keqes. ", tha Kryemadhi.

dentëve të Dhjetorit, Azem Hajdarin, edhe liderin historik të demokracisë shqiptare, Sali Berishën. Si bir i familjes ku i lind dhe i krahinës ku u rrit, Azem Hajdari ju përket ju, i përket Tropojë dhe ju jeni krenarë për birin tuaj. Si udhëheqës politik, Azem Hajdari i përket PDSH-së, themelues dhe kryetari i

parë i së cilës ishte. Si Heroi i Demokracisë, Azem i përket gjithë Shqipërisë, i përket gjithë kombit", theksoi z.Basha. Liderin e Lëvizjes së Dhjetorit, ai e sheh si frymëzim e tij për liri. "Në mendjen dhe në zemrën time, kujtimi i ndritur i Azem Hajdarit vjen me mesazhin e gjallë e frymëzueses së liria nuk është një dhu-

ratë e përjetshme, se liria u përket atyre që e duan dhe e çmojnë si më të shtrenjë gjë në jetë, se liria shërbehet e duhet të shërbehet me përkushtim e sakrificë. Liria fitohet e mbahet me betejë, duke shkruar çdo ditë në luftë për të. Liria është mision për drejtuesit politikë", deklaroi kreu i PD.



Kreu i qeverisë Edi Rama në emisionin "Zonë e Lirë" në Tv Klan, foli për Saimir Tahirin, si u njoh me të dhe për dosjen "Habibaj" ku dyshohet i përfshirë edhe ish-ministri i Brendshëm. Në rolin e prokurorit, Arjan Çani e ka marrë në pyetje kryeministrin Edi Rama. I pyetur çfarë i tha kryeministri kur mësoi se u kishte shitur makinën Habibajve, ai i tha Saimir Tahirit se makinën e ka bërë ushqim për qentë.

Emri i Tahirut u përfol pas arrestimit të babait të tij në 2013. U takuat në 2013?

Nuk mbaj mend takim konkret, por në asnjë takim nuk ka kërkuar asgjë përveçse besimit për punën. Nuk më ka kërkuar asgjë.

Kur e bëtë ministër të Brendshëm e peshuat skandalin e babait të tij?

Populli thotë 'Çdo berr varet nga këmbët e veta'. Unë them çdo berr varet nga vendimet e veta. Djali nuk mban përgjegjësi për babain dhe babai nuk mban përgjegjësi për djalin burrë. Edhe sikur të ishte dënuar i ati, unë nuk do ndryshoja qëndrim.

I kërkuat shpjegime Tahirut pasi i vunë tritol?

I shprehja gjithë keqardhjen dhe solidaritetin dhe për atë deklaratë të Berishës kur tha 'Bombën e vuri vetë'.

Hetuat mbi Tahirin në atë kohë?

Prokuroria e Krimeve të Rënda ka nxjerrë urdhër arresti për veprime terroriste për 6 shtetas, 2 prej tyre u arratisën. Falë gjykatës doli që nuk provohen aktet terroriste.

Kishit dënimin për përgjimet e paligjshme të Saimir Tahirut me pajisjen IMC Catcher?

As kam menduar, jo më pastaj të kem pasur dënim, as kam menduar që Saimir Tahiri mund të bënte përgjime të paligjshme. Për Saimir Tahirin mund të thuhet shumë gjëra, mund të rreshtohen njerëzit dhe mund të radhisin shumë defekte si për çdo njeri tjetër, por Saimiri nuk është skuth që të bënte përgjime.

Ish-zvministri i Brendshëm i LSI-së në atë kohë, Ilir Marko tha se shkarkimin e Tahirut e kanë kërkuar ndërkombëtarët pasi dilte në përgjimet e tyre?

Këtë personazh unë nuk e njoh dhe kam kërkuar shkarkimin e tij kur kam lexuar një deklaratë që bëri dhe mbi bazën e asaj deklaratë kuptova se ai leh për llogari të padronëve.

A ishit në dënimin se Saimir Tahiri po përgjohet?

Nga kush?

Nga partnerët?
Së pari, përgjimi i një anëtarit qeverie të vendit apo të një vendi tjetër, jo këtu, por

Kryeministri sqaron për herë të parë pozicionin për rastin "Tahiri"

Rama: Çfarë i thashë Saimirit për "Audin" që ua shiti Habibajve

"Mua nuk më bën presion as Ilir Meta, as ndërkombëtarët"



Kreu i qeverisë Edi Rama dje në emisionin "Zonë e Lirë"

ar, gjykata e ka dënuar dhe pastaj ka folur për Saimir Tahirin.

A i verifikuat akuzat e Zaganit, sepse ai ishte oficer i shtetit dhe a dini se ku ka përfunduar?

E di ku ka përfunduar, por në Republikën e Shqipërisë, ai është dënuar nga Gjykata e Krimeve të Rënda dhe me këto farë gjykatash ose je i pandehur politik, ose kaq shumë provohet fajësia jote, sa nuk bëjmë dot një pazar për të liruar. Kështu që kur e ka dënuar Gjykata e Krimeve të Rënda dhe prokuroria e ka çuar për shpërdorim detyrë dhe nuk e di se çfarë tjetër, çfarë duhet verifikuar më shumë?! Ajo prokurori dhe ajo gjykatë nuk kanë pasur asnjë arsye në botë që të lëvizin një gisht për hatër të Saimir Tahirut.

A mbani mend çfarë i keni thënë ju Tahirut kur morët vesh se i kishte shitur makinën Habibajve?

Kur e diskutuam mbaj mend se i kam thënë pse nuk thua që e paske bërë makinën ushqim për qentë që s'të ndahen më nga pas.

Kishit dënimin për lidhjet e Tahirut me Habibajt? I kërkuat shpjegime se përse një ministër i Brendshëm, shoqërohet me kushërinjtë të përfshirë në trafikimin e narkotikëve?

Kur ka dalë çështja në atë moment, kemi diskutuar gjërë e gjatë, kam dëgjuar të gjitha shpjegimet e tij dhe i kam mbështetur aty në vend që të shkonte menjëherë në prokurori dhe të vihej në dispozicion të hetimit për këto palokushërinj. Prokuroria e ka hetuar çështjen, dhe nuk ka rezultuar të ketë prova për përfshirjen e tij në këtë çështje.

A ju ka informuar SHISH për Habibajt dhe lidhjet e tyre me Tahirin?

SHISH nuk më ka sjellë një informacion zyrtar mbi asnjë lidhje të ministrit të Brendshëm me ndonjë grup kriminal.

Një tjetër oficer i antidrogës së Fierit, Antonio Nazeraj ka zbuluar lidhjet e Tahirut me Habibajt. Cili ka qenë reagimi juaj?

Është një tjetër person që është në kërkim, sepse me vendim gjykatë është dënuar me 2 vjet për mitmarrje bashkë me dy hajdutë të tjerë ordinerë. Edhe ky ka folur pasi është zënë me presh në dorë.

dhe në Amerikë e kudo tjetër në botën demokratike është i paligjshëm dhe konsiderohet krim. Së dyti, të gjithë këta që flasim me kompetencë për kush përgjon kë, duke përfshirë persona me një detyrë publike si ajo e anëtarëve të qeverisë nuk dinë çfarë flasin.

Pse e shkarkuat Saimir Tahirin tre muaj para zgjedhjeve, nga presion i ndërkombëtarëve apo i Ilir Metës?

Ka një njeri në këtë botë që mua më bën presion, por nuk është as ndërkombëtar dhe as Ilir Meta, quhet Zaho Rama. Për sa i përket shkaqeve, unë i kam bërë publike dhe koha më dha të drejtë, sepse largimi i katër ministrave për t'u përfshirë me kohë të plotë në fushatë, duke na dhënë një rezultat që ndoshta mund të mos e kishim marrë aq cilësor nëse ata nuk do kishim pasur këtë angazhim.

Çfarë ju tha Saimir Tahiri pas akuzave të ish-shefit të antidrogës Dritan Zaganit i cili ishte i pari që foli për implikimin e tij me grupin e Habibajve?

Nuk ishte i pari që foli, por ishte ligji që foli kundër tij, sepse njerëzit nuk e dinë ose askush nuk e ka kujtuar që në atë kohë zotëria është i dënuar nga Gjykata e Krimeve të Rënda për dekonspirim të operacionit të policisë kundër një grupi trafikantësh, pra për bashkëpunim me këtë grup. Është i dënuar.

Pra, ai ka folur pas dënimin?

Sigurisht që ishte dënuar kur ka folur. Është arrestuar për këtë fakt, prokuroria e Krimeve të Rënda ka hetu-

TELEFONATAT IMAGJINARE

I ftuar në emisionin "Zonë e Lirë" në "Tv Klan", Kryeministri Edi Rama iu përgjigj "telefonatave" që mbërrinin në sekretarinë e tij telefonike.

Moderatori Arjan Çani bëri rolin e telefonuesve, duke imituar personazhe të ndryshëm të Partisë Socialiste që telefonojnë kryeministrin, por jo vetëm.

ARJAN ÇANI: Alo Sali Berisha jam! O Evdin Habili, Edvin dëgjo, një këshillë kam: Shite Saje qorin se ndryshe nuk e mbyll dot mandatin...

EDI RAMA: Eh mor plako, unë e ti kemi të njëjtin problem, emë pak, por mua nuk më del njeri në gjumë çfarë i bëra. E di që s'do esh, por bë si të bësh.

ARJAN ÇANI: Lul Basha jam. Po të nis me email se si rriten dhe shartohen trëndalut.

EDI RAMA: Eh mo Lul thashë se u bërë burrë po lulet, lule mbeten.

ARJAN ÇANI: Luli jam prapë. E pe sa bukur u solla në parlament për Sajmen. Për sa kohë të ngeci vetingu, jemi ortak.

EDI RAMA: O Lul është koha e gjumit për ty vlla, nuk ke takat për Çanin.

ARJAN ÇANI: O i gjati, Ilir Meta jam. Duhet të takohemi patjetër, kemi lënë ca gjëra pa u mbyllur. Nëse do ta shpëtosh Tahirin, mos e prek Adriatik Llalën.

EDI RAMA: Me qetësi dhe dashuri z.President.

ARJAN ÇANI: Alo Mona jam. O kriminel kujt i thua motër ti? Unë motra jote?

EDI RAMA: Iku tepsia, ka shpërthyer dashuria për atdheun tani. Megjithatë motra ishe, motra mbetesh.

ARJAN ÇANI: O Edo Gaz Demi ja. Ta kryeva porosinë.

EDI RAMA: Gazo rrotë Partizoni se ka nevojë për inkurajim në këtë fazë.

ARJAN ÇANI: O shef Sajme jam. Erdhi kontrolli shef, po të informoj që u qëndrova stoik. Ata s'kanë parë gjë akoma. Pas puros do filloj dhe trefletshin.

EDI RAMA: Është fake, puro në PS pi vetëm Bashkim Fino.

ARJAN ÇANI: Sajmir jam shef, ju Tahiri, ai shoferi i kamionit.

EDI RAMA: Shko te fronti se aty të kërkojnë...

ARJAN ÇANI: O vlla jam Moisi Habibaj.

EDI RAMA: Palo kushëri....

ARJAN ÇANI: O i madh Lolo jam.

EDI RAMA: Do t'i lëmë këta....

ARJAN ÇANI: Lali Eni jam, benjaminj yt. Mos u tishito shef për Sajmen.

EDI RAMA: Më pëlqeu autobusi elektrik, por mos dil në media sikur je jashtë shtetit.

ARJAN ÇANI: O shef, Damian Gjikuuri jam. Të betohem që nuk kam asnjë faj për fotot me Habibajt.

EDI RAMA: Kjo historia e fotove...burri o del në foto, o s'del fare.

ARJAN ÇANI: Edo qorri jam. Tos Nano. Edhe Sajme qorr është, por mos ma ul kaq shumë pjacën.

EDI RAMA: Arjani do të na ngatërojë, por ne të dy bashkë folëm. (Mbyllte tha se jam i qartë).

PLATFORMA E BASHKËQEVERISJES

Bashkë me 28 anëtarët e zyrës së bashkëqeverisjes me qytetarët dhe me ministrat përkrah, kryeministri Edi Rama u tha qytetarëve se përgjegjës për të zgjidhur punën e tyre, tashmë nëpërmjet kësaj platforme janë direkt ministrat. "Kjo platformë krijon mundësinë që ta zgjidhësh problemin direkt me përgjegjësit", tha Rama dje.

GRAMOZ RUÇI

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi tha dje, se "Prioriteti i Kuvendit të Shqipërisë është forcimi i dialogut politik ekoncretizuar dhe në marrëveshjen e 17 Majit 2017". Deklaratat e kryeparlamentarit Ruçi u bënë në Konferencën e 8-të të Kryetarëve të Parlamenteve të vendeve të Ballkanit Perëndimor, që u zhvillua në Hungari.

DHURATA

Pas timonit të makinës që i dhuroi në muajin Qershor para zgjedhjeve, Arjan Çani i ka bërë Kryeministrin Edi Rama një tjetër dhuratë. I ftuar dje, në "Zonë e Lirë" në Tv Klan, Çani i dhuroi Ramës pjesën e munguar të timonit, airbag, që sipas tij të mbron në rats përplasjes e goditjes.

Arben Ahmetaj: Ja sa do të paguani për ndërtimet para '93-shit

Taksë 0.05% për 110 mijë ndërtime në proces legalizimi

Detyrimet mbi pronën përfshihen edhe ndërtimet pa leje

Ornela Manjani

Rreth 110 mijë ndërtime pa leje që janë në proces legalizimi do të përfshihen në skemën e taksës e mbi pronën nga 1 Janari i vitit të ardhshëm. Taksë do të jetë 0.05% e vlerës së tregut të ndërtimit. Përfshirja në skemën e taksimit për ndërtimet në proces legalizimi është vendosur në paketën fiskale të vitit 2018, e cila ka marrë dje miratimin e Këshillit të Ministrave. "Taksës mbi ndërtesat u nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit 'Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje', - thuhet në projektligjin e miratuar dje. Sipas të dhënave nga ALUIZNI, numri i lejeve për legalizim për periudhën 2006-maj 2017 është 132.000 objekte, nga të cilat 108.240 janë banesa dhe pjesa tjetër 23.760 janë objekte biznesi.

TAKSA MBI NDRËTESËN

"Taksës mbi ndërtesat u nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendës apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe. Taksës mbi ndërtesat u nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit 'Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje'. Taksës mbi ndërtesat u nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi. Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzimi i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën", - thuhet në nenin 22 të projektligjit për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.92/2014, "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

NDËRTIMET PARA VITIT 1993

Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj bëri të ditur dje formulën e



Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Arben Ahmetaj

PËRJASHTOHEM NGA TAKSA MBI NDRËTESAT:

- a) Pronat e shtetit dhe të njëjste të qeverisjes vendore, që përdoren për qëllime jofitimprurëse.
- b) Pasuritë në pronësi të shtetit, të kaluara me vendim të Këshillit të Ministrave, nën administrimin e shoqërive publike shtetërore.
- c) Ndërtesat e banimit, që shfrytëzohen nga qiramarrësi me qira të paliberalizuara.
- d) Ndërtesat sociale, në pronësi të bashkive.
- e) Pasuritë e paluajtshme-ndërtesa, pronë e subjekteve juridike ose fizike, që në bazë të marrëveshjeve me bashkitë përdoren nga këto të fundit si banesa sociale.
- f) Ndërtesat që përdoren nga komunitetet fetare, në funksion të veprimtarisë së tyre.
- g) Strukturat akomoduese "hotel me katër dhe pesë yje, status special", sipas përcaktimit në legjislacionin e fushës së turizmit.

SHKALLA E TAKSËS MBI NDRËTESAT

- 0.05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim.
- 0.15% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike.
- 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

MBLEDHJA E TAKSËS

- 1. Njësia e vetëqeverisjes vendore është autoriteti përgjegjës për funksionet në administrimin e taksës mbi ndërtesën, sa i përket pasurisë (ndërtesës) që është në juridiksionin e saj, si më poshtë vijon:
 - Mbledhjen dhe menaxhimin e informacioneve mbi ndërtesën për qëllime fiskale.
 - Përditësimin e të dhënave të regjistrit qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (kadastra fiskale).
 - Mbledhjen me forcë të detyrimeve të taksës mbi ndërtesën.
 - Korrigjimin e të dhënave në lidhje me logaritjen e taksës, në rastet e saktësisimit të informacionit për sipërfaqen, vendndodhjen zonale, çmimet e tregut etj..
 - Shqyrtimin e ankimit administrativ të taksapaguesve.

taksimit për ndërtimet para vitit 1993. Kështu, për individët dhe qytetarët taksë fikse për metër katror do të jetë 0.05 për qind, duke iu referuar ndërtesave para vitit '93, ndërsa për sipërmarrjen do të jetë 0.15 për qind. "Taksë e pronës prek të gjithë sistemin. Po kalojmë në fazën e miradmitimit të kësaj taksë. Është një taksë fikse për metër katror, për individët dhe qytetarët do të jetë 0.05 për qind sipas ndarjes së

udhëzimit numër 9 dhe VKM, që u reformohet vlerave minimale fiskale për shtëpitë e ndërtuara para vitit 1993. Kështu, ata që kanë shtëpi të ndërtuara para vitit '93 kanë vlerë më të ulët, ndërsa për sipërmarrjen vlera do të jetë 0.15%. Pra, është ruajtur një raport proporcional mes individit dhe sipërmarrjes", u shpreh Ahmetaj.

SHKALLA E TATIMIT

Shkalla e taksës mbi ndërtesat, e cila aplikohet si për-

qindje e bazës së taksës është si më poshtë: 0.05% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për banim; 0.15% për ndërtesën që përdoret, shfrytëzohet për veprimtari ekonomike dhe 30% e shkallës së taksës përkatëse për të gjithë sipërfaqen ndërtimore, për të cilën zhvilluesi është pajisur me leje ndërtimi dhe nuk ka arritur ta përfundojë atë sipas afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

TAKSA MBI NDRËTESAT

1. Taksës mbi ndërtesat u nënshtrohen individët, personat fizikë ose juridikë, vendës apo të huaj, pronarë ose përdorues të pasurive të paluajtshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, pavarësisht nga niveli i shfrytëzimit të këtyre ndërtesave, përveç rasteve kur në këtë ligj përcaktohen ndryshe.

2. Taksës mbi ndërtesat u nënshtrohen personat që kanë aplikuar për legalizim të ndërtesës, sipas ligjit "Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje".

3. Taksës mbi ndërtesat u nënshtrohen zhvilluesit, të cilët nuk arrijnë të mbyllin ndërtimin sipas lejes përkatëse, të lëshuar nga autoriteti i planifikimit. Afati i përlogaritjes së taksës fillon nga momenti i mbarimit të afatit kohor të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.

4. Detyrimi për taksën mbi ndërtesat llogaritet si shumëzimi i bazës së taksës me shkallën e taksës mbi ndërtesën.

5. Taksë vendore mbi pasurinë e paluajtshme-ndërtesë llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit. Paguesa e taksës bëhet çdo muaj apo, për periudha më të gjata, në varësi të kategorisë së taksapaguesit, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.

SHKURTE

Tatimitimi, zero tek turizmi dhe 5% tek IT

Hotelet me 4 dhe pesë yje nuk do të paguajnë tatimitimi për një periudhë 10-vjeçare, nëse arrijnë që të përfitojnë statusin special. Është kjo një nga xifrat më të mëdha fiskale, që qeveria ka vendosur t'u japë investitorëve të ardhshëm në turizëm. Turizmi pa taksë, por vetëm për ata që s'kanë ardhur ende "Përfshirja nga tatimitimi, aplikohet për një periudhë 10-vjeçare për ato struktura, të cilat përfitojnë autorizimin nga Këshilli i Ministrave deri në dhjetor 2024. Efektet e përjashtimit nisën në momentin e fillimit të veprimtarisë ekonomike të strukturës akomoduese, por jo më vonë se 3 vjet nga marrja e statusit special. Efekti negativ në buxhet llogaritet 93 milionë lekë.

Taksa për makinat e luksit

Në draftligjin "Për taksat kombëtare", që kaloi në qeveri brenda një ndryshim në nenin për taksimin e makinave të luksit. Që të taksohen një automjet për këtë arsye, duhet të përmbushë një nga dy kriteret: ose të ketë cilindratën e barabartë/ mbi 3000 cm³, ose të ketë vlerën, çmimin të barabartë/ mbi 5 milionë lekë. Sipas DPTSHRR, janë rreth 909 autovektura të regjistruara aktualisht me kapacitet 6+1, të cilat u janë nënshtruar modifikimeve për arsye të shmangies së kësaj taksë. Efekti negativ në buxhetin e shtetit është 19.000.000 lekë nga mostaksimi i këtyre automjeteve, të cilat duhet të konsiderohen makina luksi. Për këtë qëllim propozohet me anë të këtij ligji, rritja e kapacitetit të vendeve nga 4+1 në 6+1.

Ndryshimet në TVSH

Ligji "Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar" ka pësuar ndryshime në paketën e 2018-ës, ku propozohet së pari vendosja e një niveli TVSH-je prej 6 për qind për furnizimin e shërbimeve që ofrohen në hotelet me 5 yje me status special. Aktualisht ky nivel TVSH-je ofrohet vetëm për furnizimin e shërbimit të fjetjes në gjithë strukturat akomoduese në vend. Por, trajtimi i diferencuar do të bëhet vetëm për ata me status special, që do të thotë se edhe bar-restorantet, saunat, pishinat, shezlonget e këtyre hoteleve do të faturonjë shërbimin me 6% TVSH. Drafti gjithashtu i hap rrugë ndryshimit që do të bëhet për futjen në regjim TVSH-je e biznesit të vogël me një prag 2 milionë lekë qarkullim. Qeveria nuk ka përcaktuar prag në këtë rast, por ka bërë ndryshimet që i hapin rrugë procesit. Kjo masë pritet të ketë një efekt 1.5 miliardë lekë në buxhet.

EPSA SHQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A." SHPK NUOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PËR :

"Apartament" me sip. 237.15 m², Nr. Pas. 4/208+1-31, Vol.30, Fq.147, ZK 6514, e ndodhur në Durrës. Kjo pasuri është e hipotekuar në favor të Banka Intesa SanPaolo Shqiperi sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi është 71.719 Euro. Ankandi do të zhvillohet datë 16.11.2017 ora 16.00 në adresën Rr."L. Qemali", Pall."Fratar", K.6,Tirane.

Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al

EPSA SHQËRIA PËRMBARUESE PRIVATE "E.P.S.A." SHPK NUOFTON SHPALLJEN E ANKANDIT PËR :

- 1- "Trenal" me sip. 200 m² nga kjo ndërtesë 114 m². Nr. pasurie 9/584, Vol. 27, Faqe 87, ZK 6532 i ndodhur në Sheq i Madh, Fier. Pasuria është hipotekuar në favor të Bankës Alpha sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi i është 54.400 Euro, Ankandi për do të zhvillohet datë 30.10.2017 ora 16.00 në adresën Rr."L. Qemali", Pall."Fratar", K.6,Tirane.
- 2- "Arë" me sip. 9.159 m². Nr. pasurie 117/37, Vol. 10, Faqe 165, ZK 3981, i ndodhur në Sheq i Fier. Pasuria është hipotekuar në favor të Bankës Alpha sh.a. Çmimi me të cilin fillon ankandi i është 58.400 Euro. Ankandi për do të zhvillohet datë 30.10.2017 ora 16.00 në adresën Rr."L. Qemali", Pall."Fratar", K.6,Tirane.

Per cdo informacion kontaktoni ne tel. 04 2262711 ose ne www.epsa.al.

Zyra Përmbarore Kozeta Caka njofton shpalljen e ankandit i për shpalljen e "Pasurisë së Paluajtshme të ligji are, me Nr. 101, të ndodhur në ZK 2941, vol 3, fq. 94, me sipërfaqe 400 m², Pëtleke, Tirane", në pronësi të dobitorit Ismail Gjata. Ankandi fillon me çmim fillestar 1.713.256 lekë. Ankandi do të zhvillohet me datë 07.11.2017, ditën e martë, ora 15:30 - 16:30, pranë Zyres Përmbarore Private Kozeta Caka në adresën: Bulevardi "Bajram Curri", Pallati "Palma e Artë", Kati 1, Nr. 22, Tirane. Të Interesuarit të kontaktojnë në Tel: +355 44532280.

Dy akuzat për ish-ministrin e Brendshëm, kush janë hetuesit

Saimir Tahiri në prokurori: I gatshëm për çdo hetim

Prokurori Hajdarmataj i çon ftesë për t'u paraqitur

Ina Allkanjari

Pas akuzave të ngritura nga prokuroria e krimeve të rënda për "Trafikim të lëndëve narkotike", drejtuar ish-ministrit të Brendshëm Saimir Tahiri, ky i fundit ka deponuar para hetuesve mbi atë çfarë e lidh me këtë ngjarje. Prokuroria e krimeve të rënda me 26 tetor 2017 kontrolloi shtëpinë e ish-ministrit ndërsa një ditë më pas, me 27 tetor i dërgoi një ftesë për paraqitjen të kjo prokurori. Ftesa për paraqitje drejtuar Tahirit mban firmën e titullarit të Prokurorisë së Krimeve të Rënda, Besim Hajdarmataj. Ish-ministri i Brendshëm shprehu gatishmërinë për të dhënë shpjegime dhe për të sqaruar pozicionin e tij në lidhje me përfshirjen me grupin Habilaj, siç dyshon prokuroria, ndërkaq që më parë ai u shpreh se ka qenë ai që ka kërkuar marrjen në pyetje për zbardhjen sa më të shpejtë të kësaj çështjeje.

Në orën 14:01 ish-ministri mbërriti pranë Prokurorisë për Krimet e Rënda. Ai u paraqiti me dy avokatët e tij Artan Hajdari dhe Maksim Haxhia. Gjatë deklaratës së dhënë, ish-ministri i Brendshëm deklaroi se do t'i shkojë deri në fund të drejtës dhe të vërtetës së tij, ndërsa ka kërkuar që t'i jepet fund debatit politik për këtë çështje. Pasi ka lënë ambientet e prokurorisë, ku është marrë në pyetje për gati 2 orë e gjysmë, deputeti Tahiri ka folur për mediat. "Unë nuk kam ndërmend ta bëj betejën time për drejtësi para jush, apo akoma më keq ta kthejnë në një histori debati politik. Mendoj se debati politik për këtë histori duhet të mbyllet. Unë këtë betejë e kam me drejtësinë", - u shpreh ai. Tahiri nuk dha përgjigje konkrete mbi pyetjet që dy prokurorët e çësht-



Ish-ministri i Brendshëm Saimir Tahiri, djeg duke dalë nga Prokuroria e Krimeve të Rënda

ishte punë e dyfishtë. Unë jam tërësisht i disponueshëm për t'u përgjigjur çdo pyetje, i hapur për çdo hetim, do t'i shkojë deri në fund të drejtës dhe të vërtetës sime", - u shpreh Tahiri.

GRUPI HETIMOR

Sakaq, tre prokurorët të tjerë të çështjes, të kryesuar nga Besim Hajdarmataj janë duke kryer veprime të tjera hetimore, si sekuestrimi i dokumenteve nga institucione të ndryshme, siç është Ministria e Brendshme, Drejtoria e Policisë dhe policitë vendore, siç është ajo e Vlorës. Akuzat më me rëndësi ndaj ish-ministrit Tahiri, është ajo për "Trafikimin e narkotikeve, e kryer në bashkëpunim në kuadër të grupit të strukturuar kriminal", dhe akuzohet për lidhje me Habilajt. Hetimi ndaj tij nisi pas arrestimit në Itali të Moisi Habilajt, kreu të bandës kriminale, dhe publikimit të përgjimeve të kryera nga autoritetet e Katanias.

Vetëm dy muaj pasi ishte emëruar ministër i Brendshëm në 2013, Tahiri u shiti Habilajve makinën e tij. Dhe vetëm një vit pasi e kish të shitur atë, jo vetëm nuk i kishte ndërruar pronësinë, por e ka përdorur mjetin "Audi" për të udhëtuar drejt Greqisë bashkë me familjen, dhe sipas prokurorëve aty është takuar edhe anëtarë të fisit Habilaj. Kjo ishte dëshmia e parë e deputeti Tahiri, ndërsa procesi vijon.

'Zhduket' 'Audi' A8 i Habilajve, DPTR:

Kjo targë s'është më në qarkullim

Hetuesit kanë kërkuar automjetin tip "Audi" me targë AA003GB, por pa mundur ta gjejnë atë. Pasi u denoncua si automjeti i ish-ministrit të Brendshëm, që përdorej nga Habilajt, targa e mjetit AUDI mësohet se është çregjistruar në Drejtorinë e Transportit Rrugor. Nga një kërkim që ka bërë prokuroria rezultoi se kjo targë nuk është më në qarkullim. Po ashtu hetuesit kanë kërkuar edhe automjetin, i cili ndër të tjera rezultoi me hyrje-dalje drejt Italisë, aty ku kanë zhvilluar aktivitetin e trafikut të drogës Habilajt, por edhe automjeti nuk është gjetur. Mësohet se pas çregjistrimit të targës AA003GB, makina është ritaruar, por nuk dihet vendndodhja e saj.

tjes i kanë parashtruar apo provat që mund t'i kenë paraqitur. Por theksoi se është i hapur për hetimin. "Me kërkesën time u paraqita për të dhënë shpjegimet e mia dhe për të shprehur gatishmërinë sot dhe kur-

doherë për t'i shkuar të vërtetës deri në fund me çdo mjetimin, dhe disponibilitetin, persona për t'u përgjigjur çdo kërkesë të prokurorisë. Do ju kërkoja që atë që bëra me prokurorët brenda mos ta bëja edhe këtu, se do

DY AKUZAT

Ndaj deputetit të përjashtuar nga Grupi i Partisë Socialiste, është hapur një çështje penale për akuzat e trafikut të narkotikëve, pjesëmarrjes në grup të strukturuar kriminal, korrupsionit pasiv dhe shpërdorim detyrë.

Grupimi i të djathtëve në PPE reagon për Shqipërinë

"Tahiri", PPE thirrje Ramës: Ndalo presionin politik ndaj prokurorisë

Grupimi i Partisë Popullore Europiane ka reaguar lidhur me çështjen Tahiri dhe votimin e Kuvendit kundër arrestimit të tij. Përmes një deklarate për mediat, PPE ku aderohet edhe Partia Demokratike, ngre shqetësimin se maxhoranca ka marrë në mbrojtje Tahirin dhe po ushtron presion ndaj Prokurorisë së Krimeve të Rënda. "Grupi i Partive Popullore Europiane ka ndjekur me vëmendje presionin politik të kohëve të fundit mbi prokurorinë, nisur nga fakti se Prokuroria Shqiptare për Krimet e Rënda, i ka kërkuar Kuvendit heqjen e imunitetit për ish-ministritin e Punëve të Brendshme, Saimir Tahiri në mënyrë që ta hetojë për akuzat e korrupsionit dhe trafikimit të drogës. Megjithatë, Partia Socialiste, shumica qeverisëse në Kuvend, në 25 tetor votoi kundër heqjes së plotë të imunitetit politik të Tahirit". Duke deklaruar mbështetjen për kreun e PD-së Lulzim Basha, grupi i Partive Popullore Europiane i bën thirrje kryeministrit Edi Rama dhe shumicës qeverisëse të ndërpresin menjëherë presionin politik ndaj prokurorisë si dhe të kanalizojnë instrumentet e tyre politike, në mbrojtje të drejtësisë. Grupi i Partive Popullore Europiane, nënvizon se dekriminalizimi i zyrtarëve publik është një hap i rëndësishëm për fuqizimin e kulturës politike në vend.



United Nations Development Programme

TENDER ANNOUNCEMENT

Subject: ITB FOR RECONSTRUCTION OF CRËCHE IN "DONIKA KASTRIOTI" QUARTER, BERAT MUNICIPALITY

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the provision of the above mentioned services/works.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline, set in a sealed envelope and with clearly marked "RECONSTRUCTION OF CRËCHE IN 'DONIKA KASTRIOTI' QUARTER, BERAT MUNICIPALITY".

For more details please refer to the link below:
http://procurement-notices.undp.org/view_notice.cfm?notice_id=42054

Relevant Dates: All interested companies should provide their offer in the following address, not later than 9 November 2017, at 14:00 hrs

Address for Communication and offers' submission:

United Nations Development Programme Albania
 Str. "Skënderbej", Gurten Center, 2nd floor,
 Tirana, Albania
 Fax.No: + (355) 4 225 02 86
 E-mail: procurement.al@undp.org

United Nations Development Programme

TENDER ANNOUNCEMENT

Subject: ITB for "CONSTRUCTION OF SEWAGE SYSTEM AT ROMA AREA, QUARTER 30 VJETORI, BERAT MUNICIPALITY"

The United Nations Development Programme in Albania is seeking to receive offers from interested companies who wish to be considered for the provision of the above mentioned services/works.

Companies will be selected in accordance with established UNDP procedures. The offers must be delivered within the deadline, set in a sealed envelope and with clearly marked "CONSTRUCTION OF SEWAGE SYSTEM AT ROMA AREA, QUARTER 30 VJETORI, BERAT MUNICIPALITY"

For more details please refer to the link below:
http://procurement-notices.undp.org/view_notice.cfm?notice_id=42053

Relevant Dates: All interested companies should provide their offer in the following address, not later than 6 November 2017, at 14:00 hrs

Address for Communication and offers' submission:

United Nations Development Programme Albania
 Str. "Skënderbej", Gurten Center, 2nd floor,
 Tirana, Albania
 Fax.No: + (355) 4 225 02 86
 E-mail: procurement.al@undp.org

ISH-TE PERNDJEKURIT DEMSHPERBLIMI

Dokumentet duhet të dorëzohen brenda 2 muajve për këstin e parë dhe të dytë

Ornela Manjani

Ministria e Financave ka publikuar listën e kategorisë joparësore në radhët e ish-të përndjekurve politikë që mund të trajtohen me dëmshpërbim, por që sipas këtij dikasteri duhet të sjellin dokumentet e nevojshme. Bëhet fjalë për listën e kategorisë joparësore, për trashëgimtarët, rreth 840 përfitues të cilët do të marrin dëmshpërbim, por më parë duhet të plotësojnë dosjen me dokumentet. "Gazeta Shqiptare" publikon listën e plotë përfituesve të këstit të dytë, të cilët duhet të plotësojnë dokumentet brenda 2 muajve për të marrë dëmshpërbimin.

Ish-të përndjekurit, 840 përfituesit e rinj të këstit të dytë

Ministria e Financave: Fëmijët dhe nipërit e ish-të dënuarve të plotësojnë dosjet

lllogaria e tyre është aktive. Në rast se llogaria nuk është aktive, shumica e dëmshpërblimit këthehet mbrapsht në buxhet, duke sjellë vonesa dhe ndërlikime të pa-nevojshme. Kur kemi ndryshim të identitetit, (emër/mbiemër), apo në rastet kur në certifikatë ndryshon emri ose mbiemri, qoftë edhe me

një shkronjë të vetme në krahasim me dëshminë e trashëgimisë apo prokurës, kartës së identitetit dhe çdo dokumenti tjetër të nevojshëm, duhet medoemos që në të gjitha dokumentet, emrat të jenë të njëjtë me atë që është shkruar në certifikatë e lëshuar nga gjendja civile. Në rast se ka transkriptime të

gabuar gjatë kohës nga një certifikatë e një periudhe të caktuar, atëherë këto ndryshime duhet të pasqyrohen brenda formatit të certifikatës apo edhe të një vërtetimi të veçantë të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Ligji parashikon edhe rastet e ekzekutimeve pa gjyq. "Në rastet e ekzekutimeve kapi-

tale pa gjyq, është i domosdoshëm një vendim fakti gjykatë që vërteton vdekjen, plus një certifikatë negative të lëshuar nga zyra e gjendjes civile. Në rastet kur për arsye të njohura në gjendjen civile nuk ekzistojnë dokumente të periudhës përkatëse dhe ky fakt vërtetohet nga gjendja civile, i in-

teresuari është i detyruar të bëjë një gjyq fakti, të cilin edhe në këtë rast si në pikën më lart, duhet ta shoqërojë me një certifikatë negative", thuhet në njoftimin që Ministria e Financave bën për të sqaruar trashëgimtarët e ish-të dënuarve, të cilët nuk kanë marrë ende dëmshpërbimin.

KËSTI I DYTË I 840 TRASHËGIMTARËT QË PËRFITOJNË DËMSHPËRBLIM

Dhimitrulla Jorgo	Seferi	VERGJINUSH	IRFAN	SAMI KADRI OSMANI	HYRI	DEMIRAJ	DILE GJOK	GJETA	Dule Ali	Caushaj
Alfize Murat Rukaj		BEGO		FIQIRETE KADRI	RUSTEM	RRAPO	PRENG	GJOK	Husi Ali	Caushaj
Aleksander Idriz	Rukaj	EDUART	IRFAN	HASANAS	KUJTIM	RRAPO	DRANE	GJOK	Hysen Ali	Caushaj
Vitore Idriz Rukaj		BUJAR	IRFAN	HASANAS	IVZI	RRAPO	KOL GJOK	MARKU	Vero Ali	Caushaj
Sofie Idriz Rukaj		ELEZ HALIL	KAZIU	HYSEN KADRI	RUSHAN	RRAPO	ZEF GJOK	MARKU	NESIBE	DALIP
Barbuqe Idriz	Rukaj	NAZIMETE	HALIL	HYSAJ	MEKHDLIE	BAJRAM	ALI	LLESHLLESHI(CENAJ)	GJINOVEPA	HETEM
Adam Idriz Rukaj		NADIRE	HALIL	KUBURJA	FETA	BAJRAM	BERNARDINA	KEL HARAPI	DHURATA	HETEM
Fatushe Idriz	Cepelia	ISMAIL	HALIL	KAZIU	NOVRUZ	BAJRAM	ZEF	LEC HARAPI	KUJTIM	HETEM
Xhemalije Selim	Shema	BASHKIM	HALIL	KAZIU	HEDIRE	BAJRAM	TONIN	LEC HARAPI	GJORGJIA	THIMI KOROVESHI
Nazmije Selim	Sefa	KUJTIME	HALIL	RAMI	MAKBULE	KADRI	ROZINA	LEC LUKA	ARSINO	ANASTAS LOLE
Haxhire Selim	Hasanraku	FARJUE	ZYBER	CAMI	HARUN	KADRI	LUTFI	HAKI	EDMOND	ANASTAS KO-
Shazije Selim	Domni	NEXHAT	ESAT	CAMI	SHIPIE	KADRI	RUDI(LLUBANI)		ROVESH	
Skender Selim	Domni	BEHAR	ESAT	CAMI	DIZE	KADRIMERJA	BUJAR	HAKI	JANI	ANASTAS KOROVESHI
Drita Selim Kodra		DHURATA	ESAT	SELAMI	RASIM	KADRI	NAIM HAKI	LLUBANI	THOMA	ANASTAS KOROVESHI
Ramadan Selim	Domni	ELMAS	ESAT	CAMI	NAIM KADRI	HOXHA	BASHKIM	HAKI	VJOLLCA	ANASTAS IKONOMI
Ramzan Selim	Hoxha	DYLIBER	ESAT	CAMI	KOSTA(KOÇO)		VALENTINA	HAKI	Benjamin	Gjush Deda
Shefikate Tahir	Dokushi	NAFIZE	RESNJAKU		DHIMITRI(FUSHEKA)		EMANUELA	HAKI	Paulin	Gjush Deda
Qerim Tahir Hoxha		GEZIM	MUHAMED		KLEDIA	ZEF PEROLLI	QERIME	HARKA	Tonin	Gjush Deda
Hasan Dervish	Zeneli	RESNJAKU			GJYLJE	ISLAM NELA	XHAFE	ISMAIL	NEKJIE	HASIM KAMBERAJ
Shaban Dervish	Zeneli	FLUTURIME	MUHAMED		KUJTIM	SHERIF NELA	MARTA	ISMAIL	AFERDITA	SAMI ABDIAJ
Zyra Dervish	Ibrahim	GJOLEKA			HUME	SHERIF NELA	NUREDIN	ISMAIL	BESNIK	SAMI KAMBERAJ
Ysmail Dervish	Zeneli	FATMIR	MUHAMED		ZAIM	SHERIF NELA	VASIL	ISMAIL	BUJAR	SAMI KAMBERAJ
Caf Dervish	Zeneli	RESNJAKU			BAFTLJE	SHERIF NELA	KUDRET	ISMAIL	DEFRIM	SAMI KAMBERAJ
Shego Sadush	Shahaj	BASHKIM	MUHAMED		SOKOL	SHERIF NELA	HEDLJE	ISMAIL	JONUZ	SAMI KAMBERAJ
Qani Rrapo Shahaj		RESNJAKU			PELLUMB	FAIK KULLA	EQREM	ISMAIL	LAVDIMIR	SAMI KAMBERAJ
Fejzo Rrapo Shahaj		DAVE	MARK GJOKA		HALIM	FAIK KULLA	AJET	ISMAIL	HARKA	SHQIPONJE SAMI EMINAJ
Zenun Rrapo	Shahaj	DILE	FRROK	FRROKAJ	VERGJINUSH	FAIK	ALEMSHA	SALI	RIZA	AVDI NEZAJ
Skender Rrapo	Shahaj	GJERGJ	FRROK	GJOKA	AGO		BURBUQE	SALI	QERIM	AVDI NEZAJ
Ali Rrapo	Shahaj	PAVLIN	FRROK	GJOKA	EGLANTINA	FAIK SPAHO	SI		AJSHJE	AVDI MUCAJ
Bajram Rrapo	Shahaj	LEKE	FRROK	GJOKA	FIQRI	FAIK KULLA	MANUSHAQE	SALI	HAVE	AVDI DANAJ
Fasli Rrapo	Shahaj	PASHK	FRROK	GJOKA	PRENE	ZEF GJOK GJINI	SHYTI		RUSHE	AVDI MUSTAVATAJ
Kristina Vangjel	Ruço	AHMET	REXHEP	KORTOCI	ZEF	GJOK GJINI	DILE	JONUZ	MUDE	SALI HOXHA
Olimbi	Andoni	AVDUL	MYRTEZA	FERHATI	MARK	GJOK GJINI	XHIDLJE	JONUZ	SHAQIR	HYSEN HOXHA
Sarandi	Ruço	AGRON	LUTFO	TOTO	JANI	NIKOLLA SHKOPI	MI		NESIM	HYSEN HOXHA
Sofika	Mihal	FATBARDDHA		LUTFO	ANTHULA	NIKOLLA CEOO	DITURI	JONUZ	MEKSHI	NDOC KOLE KURTI
Koço Mihal Ruço		SPAHHU			SPIRO	NIKOLLA SHKOPI	LUZE	JONUZ	EMILJA	KOLE KURTI
Arqile Mihal	Ruço	DONIKA	LUTFO	CEKA	VANGJEL	NIKOLLA SHKOPI	PETRIT	JONUZ	KOPACI	LUÇJE KOLE KURTI
Manushage	Spiro	KONDOR	FERHAT	CEKA	STAVRULLA	NIKOLLA BRAHO	MARA	PERGJONI	TOSKA	PERGJONI
NDUE GJON NIKOLLI		VELI	HYSEN	TABAKU	VASILIQI	NIKOLLA KARADHIMA	PRENE	GJIN	REFLJE	JEMIN MUSTAFARAJ
FAHRLJE	LAÇI	SADI	HYSEN	TABAKU	KOSTA	NIKOLLA SHKOPI	PRENG	GJIN	DALLENDYSHE	ALI
LULIANA QAZIM	DHIMA	MUSTAFI	HYSEN	TABAKU	IRINI	NIKOLLA BAXHO	FRROK	GJIN	PERGJONI	MARGARITARI
DHURATA QAZIM	BABALI	CAUSH	HYSEN	TABAKU	ISUF	HAXHI SKUKA	SHPRESA	ALI	BEKTESHI	ENVER ALI MUSTA-
ARJAN LIAN	DERGUTTI	STAVRO	QIMON	GREKA	KADRI	HAXHI SKUKA	ALTINA	LATIF	HYSA	FARAJ
MERCEDES LIAN	DERGUTTI	RASIME	ASLLAN	BALLATA	LEFTER(XHEVDET)	HAXHI SKUKA	DRILONA	LATIF	BEKTESHI	TEFTA ALI SHKUPI
DARDAN LIAN	DERGUTTI	ZENELABEDIN		NAFI			AVNI	QAZIM	VULA	SKENDER ALI MUSTA-
MANILA LIAN	DANJOLLI	BALLATA			ZAIM	HAXHI SKUKA	DIANA	HAKI	DANI	FARAJ
NURIE SELIMAJ	VJOLLCA	NAFI	TELIQIU	BALLATA	ALI	ETEM DIKOLLARI	(MULLAH)		Elmari	isuf Madhi
NUSHE AHMET	SELIMAJ	PETRIT	NAFI	BALLATA	SEKINE	ETEM RUSHITAJ	LAVDIJE	SHEFQET	(Toptani)	
ZENEL AHMET	SELIMAJ	VERANAFI	VUKA		TEFTA	ETEM SPAHO	LUAN	SHEFQET	BANAJ	Fani (evazjeli) isuf
DUSHE AHMET	BAJRAK-	BURBUQE	NAFI	MUSTAFA	VASILIOS	KOLO STEFANI-	ASTRIT	SHEFQET	BOANJ	Toptani
TARI		ADILE	HALIM	XHAFERI	DHI		YLLKA	SHEFQET	LICO	Adriatik Dylber Sejati
DRITA AHMET	SELIMAJ	ABDULLA	SMAJL	XHAFERI	LLAZO	KOLO STEFANI	FLORA	SHEFQET	CAUSHAJ	Romina Engjell Serjati
ASTRIT AHMET	SELIMAJ	AISHE	SMAJL	CAKU	KOSTANDINE	KOLO	FLAMUR	FADIL	SOPOTI	BASHKIM XHELADIN NDRU
KUJTIM AHMET	SELIMAJ	MUHAMED	SMAJL	XHAFERI	KOLE		GEZIM	FADIL	SOPOTI	VERA XHELADIN SIQECA
MARLJE NDOC	DEMA	MELIHA	SMAJL	DIMNAKU	POLIKSINI	KOLO KOTO	SHQIPE	FADIL	SHYTI	(Ndreu)
ZHANERNEST	DEMA	SERVET	SMAJL	GARUNJA	EVGJENI	KOLO NGJELJE	ALUSH	ZENEL	AGOLLI	Bajram Dan Pervizi
GENTJAN REXH	ADEMI	NEZHIA	SMAJL	SOKOLI	FOTI	KOLO STEFANIDHI	ABDULLA	ZENEL	AGOLLI	Nexhip Dan Pervizi
EDUART REXH	ADEMI	FITRETE	SMAJL	QUKU	SIMONA	KOLO RISTANI	ADEM	ZENEL	AGOLLI	Qeuthere Dan Seferi
DRITAN REXH	ADEMI	IKABRE	SMAJL	DILAVERI	ARISTOTEL	KOLO STEFANIDHI	HAMIDE	ZENEL		Sabri Dan Pervizi
ELONA REXH	ADEMI	MYFARITE	SMAJL	RRROI	AISHE	XHINDOLI	MYFTARAGA		Shpresa Ali	Fekeci
ASTRIT IRFAN	HASANAS	FATMIRA	KADRI	HAKORJA	VULLNET	BAJRAM XHINDOLI	HETO	FADIL	DIZZARI	Anton Frederik Fekeci
MIRJETA IRFAN	SEAJTLARI	GJURAN	KADRI	OSMANI	EDUART	BAJRAM XHINDOLI	Arif Ali	Caushaj		Antonjeta Frederik Fekeci
QERIM IRFAN	HASANAS	DEMIR	KADRI	OSMANI	DURIM	BAJRAM XHINDOLI	Dude Ali	Nelaj		

Table with multiple columns listing names and affiliations. Includes a large table of names and a separate section titled 'REPUBLIKA E SHQIPERISE BANKA E SHQIPERISE DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT SEKTORI I PROKURIMIT TENDER I HAPUR KOMBËTAR'.

DEKLARATA

"Kryeministri e ka harxhuar atë moment të energjisë dhe kohës së tij pa rendiment se çfarë kuptimi ka, media nuk është as për t'u kritikuar, as për t'u sharë. Medias duhet t'i përgjigjesh, duhet t'i përcosh mesazhet dhe, nëse s'të pëlqejnë pyetjet ose pozicioni, mund të qëndrosh ose të largohesh, pra kjo më duket pa rendiment", - tha Artan Fuga.

SITUATA

"Shqipëria nuk ka fytyrë, është e pafytyrë. Ka një fasadë dhe shqiptari është i pa zë. Njerëzit janë në shtëpitë e tyre, në familjet e tyre dhe vuajnë padrejtësitë, vuajnë arbitraritetet nga nëpunësi, nga ai që ka diçka në dorë. Kjo është Shqipëria që duhet zhvilluar dhe që duhet të marrë zë. Situata është e hidhur, sepse është kjo fytyra e Shqipërisë që nuk del në pah gjithmonë, por del një fytyrë tjetër. Shqipëria ndodhet në një moment të rëndësishëm që ka lidhje edhe me atë që unë shkruaj te "Murgu", - u shpreh akademiku.

SONDAZHI

"Banka Botërore përpara një muaji botoi një sondazh, që u bë në të gjithë shtetet e Europës Lindore. Sondazhi nxjerr që 35% a 40% e shqiptarëve jetonin më mirë në komunizëm se sa tani. Kur e kam dëgjuar këtë, më janë ngritur flokët përjetë dhe kam thënë: a janë në vete këta. E kaluara nuk ekziston dhe ne na duket sikur ekziston", pohoi Fuga.

Akademiku: Shqipëria është e pafytyrë, nostalgjia për komunizmin është absurde

Senad Nikshiqi

SHKODËR

Zhvendosje e vëmendjes dhe harxhim i energjisë dhe kohës pa rendiment". Kështu i ka komentuar akademiku Artan Fuga fyerjet e kryeministrit Edi Rama ndaj medias dhe gazetarëve para pak ditëve. Për Fugën, ajo që ndodhi mes kryeministrit dhe gazetarëve nuk ishte një debat, por thjesht zhvendosje e vëmendjes në ish-ministri i Brendshëm, Saimir Tahiri është apo jo i inkriminuar. Deklaratën pedagogu Fuga e bëri nga Shkodra gjatë prezantimit të librit të tij "Murgu". "Kam parë debatin bazë. Unë nuk jam shumë që politika dhe media të jenë shumë të sjellshme me njëra-tjetrën. Nga kjo pikëpamje po të ketë një përplasje, një debat nga të dyja palët brenda një lloj norme do sillte vërtetë krahas atij shokimi që ka edhe elementë të tjerë. Pra, do të thotë se unë shoh pasojat dhe jam duke analizuar faktin. Pasoja është që politika në fakt, në vend të ngjarjes "në", që është problemi i inkriminimit ose jo të ish-ministrit të Brendshëm, u krijua një ngjarje "në një", pra një ngjarje tjetër, ngjarja e kryeministrit me gazetarët, që për mua nuk ishte një debat. Kishte një zhvendosje të vëmendjes. E dyta, më duket se kryeministri e ka harxhuar atë moment të energjisë dhe kohës së tij pa rendiment se çfarë kuptimi ka, media nuk është as për t'u kritikuar, as për t'u sharë, medias duhet t'i përgjigjesh, duhet t'i përcosh mesazhet dhe nëse s'të pëlqejnë pyetjet ose pozicioni, mund të qëndrosh ose të largohesh, pra kjo më duket pa rendiment", tha Artan Fuga. Pas takimit me studentët në Shkodër, akademiku Fuga ishte në emisionin "Studio e hapur" me Eni Vasilin në "News24", ku ka treguar mënyrën sesi gazetarët duhet t'i përgjigjeshin kryeministrit Rama.

REAGIMI

Akademiku Artan Fuga u shpreh se, "kryeministri i lejon vetes të thotë ato fjalë, sepse e di që në publik nuk do të ketë impakt negativ për të. Në këtë rast pronarët e mediave nuk e kanë dëshirën për t'u konfrontuar me politikën, edhe vetë kryeministri nuk është se u konfrontua me pronarët. Në këtë marrëdhënie "koka turku" u bënë disa gazetarë të rinj të terrenit, të cilët janë në një pozitë të vështirë, sepse ata nuk kundërshtojnë dot sepse janë brenda një deontologjie. Ka ardhur një moment i ri mes

Fyerjet e kryeministrit ndaj gazetarëve, Fuga: Zhvendosje e vëmendjes, harxhim kohe pa rendiment

"Media nuk është as për t'u kritikuar, as për t'u sharë, nëse s'të pëlqejnë pyetjet, mund të qëndrosh ose të largohesh"

politikës dhe medias. Politika me rrjetet në linjë, me komunikimin në web dhe me web gazetaresk apo komunikimin direkt gjithnjë e më shumë do të ketë tendencë ta anashkalojë median dhe politika nuk ka nevojë për median nga kjo pikëpamje. Këtu është problemi i medias që sa do të dijë që edhe ajo të transformohet në mënyrë që hapësirën publike ta ketë ajo gjithmonë si komunikim, sepse audiencia nuk ka nevojë për një komunikim direkt të politikës, por ka nevojë që midis politikës dhe audiencës të jetë gazetari, sepse është gazetari që di të interpretojë, di të bëjë pyetjet, di të shprehë opinionet e audiencave të gjëra, kurse çdo qytetar më vete përpara politikantit, është i dorëzuar". Duke folur përpara studentëve, Fuga tha se Shqipëria është pa fytyrë dhe se njerëzit në këtë vend janë të pa zë. "Shqipëria nuk ka fytyrë, është e pafytyrë. Ka një fasadë dhe shqiptari është i pa zë. Njerëzit janë në shtëpitë e tyre, në familjet e tyre dhe vuajnë padrejtësitë, vuajnë arbitraritetet nga nëpunësi, nga ai, që ka diçka në dorë. Kjo është Shqipëria që duhet zhvilluar dhe që duhet të marrë zë. Situata është e hidhur, sepse është kjo fytyra e Shqipërisë që nuk del në pah gjithmonë, por del një fytyrë tjetër. Shqipëria ndodhet në një moment të rëndësishëm që ka lidhje edhe me atë që unë shkruaj te "Murgu", - u shpreh akademiku. Për Artan Fugën, nostalgjia për shtetin komunist dhe se atëherë jetohej më mirë është absurde. Ai tregoi dije edhe historinë e familjes së tij teksa u rrit në mes të komunistëve, por edhe anti-komunistëve.

HISTORIA E FAMILJES

"Unë jam vetë fëmijë komunist. Unë i qëndroj idesë së Tokvil dhe ai thotë se nuk mund të studiohet e kaluara me ideologjinë e të sotmes. Kur një shoqëri e re vjen, ka një përmbajtje kulturore, mendore, politike, ideologjike që krijon një theyerje me të



Akademiku Artan Fuga

kaluarën dhe tek e kaluara projektin veten e vet sot. Kur bisedoj me njerëz, shoh

një nostalgji të tyre për të kaluarën komuniste që unë se kam. Përtej kësaj, Banka

Botërore përpara një muaji botoi një sondazh që u bë në të gjithë shtetet e Europës Lindore. Sondazhi nxjerr që 35% a 40% e shqiptarëve jetonin më mirë në komunizëm se sa tani. Kur e kam dëgjuar këtë, më janë ngritur flokët përjetë dhe kam thënë, a janë në vete këta. E kaluara nuk ekziston dhe ne na duket sikur ekziston. Problemi është se kur vijmë dhe gjykojmë të kaluarën nga pikëpamja e ideologjisë së sotme, bëhen gabime që nuk mund të pranojnë. Themi shoqëria totalitare, a thua se nga 1944 në 1990 ka pasur një shtet në Shqipëri, jo. Në kështu bëjmë dy gabime, e para adoptojmë idenë e drejtuesve të shoqërisë totalitare, të cilët e konsideronin nga 1944 në 1990 një shtet, sepse ashtu u interesonte dhe e adoptojnë edhe ideologët e sotëm, të cilët për lehtësi thonë se ish-

te një shtet. Jo, unë kam bërë studime, dhe Shqipëria në '44-'46 është tjetër, '46-'48 tjetër, '48-'53 tjetër, '53-'61 tjetër, '61-'68 tjetër, '68-'74 tjetër, '74-'81 tjetër, '81-'89 tjetër dhe kam numëruar të paktnës 8 regjime politike të ndryshme, të cilët kanë pasur një njeri në krye, por sistemi i qeverisjes, sistemi i ligjeve, sistemi i njerëzve që aplikonin, sistemi i politikës dhe gjeopolitikave ndërkompartamentare, të tëra të ndryshuara. Unë jam për një histori politike të fragmentarizuar dhe jo homogjene, siç bëhet sot, sepse është vazhdim i asaj ideologjie që ishte. Nuk është puna e atëzimit të dikurshëm, por puna është e atëzimit sot. Unë jam rritur në një familje komunistësh të devotshëm. Babai im vinte nga një familje pronarë tokash, ndërsa nëna nga një familje avokatësh. Në 1944 tre datat e mi bashkë me gjyshin tim futen në burg për politikë dhe qëndrojnë 5-6 vite. Nëna ime sigurisht që ndahet më të, sepse nëna ime 18 vjeç del partizane dhe plagoset dhe jeton në mal. Familja e përzë, sepse i thotë: nuk je në rrugën e duhur. Jetoja në një familje me situatë të vështirë. Xhaxhai im mbaron studimet në Leningrad për inzhinieri marine dhe vjen nën ndikimin e Krushovit, vjen dhe flet kundër regjimit stalinist dhe e internojnë në Pushë Arrëz. Kjo është familja ime. Ca ish-të pasur të deklasuar, ca ish komunistë të bindur dhe të devotshëm, ca të tjerë të internuar, ca nëpër burgje dhe unë një djalë i vogël. Zakonisht të vërtetën e di budalla, i vogli dhe i huaji. Të tre të dobët janë dhe e vërteta është te i dobët, i forti kujton se ka të vërtetën, por s'ka asgjë. Unë si i vogël, gjithë më flasin mua, qanin hall tek unë, se te njëri-tjetri jo. Vinte gjyshja më thoshte, ua ç'na bënë këta komunistët, vinin komunistët dhe thoshin: ai gjyshi që do na marrë në qafë, ja, kjo është".

Prokuroria: Arjan Ndoji akuzohet për "Shpërdorim detyre"

Arrestoi viktimën e dhunës dhe la të lirë agresorin, arrestohet ish-shëf i Krimeve

DURRËS - Ish-shëf i Krimeve të Drejtorisë e Policisë së Qarkut të Durrësit ka përfunduar në pranga, pasi akuzohet për veprën penale "Shpërdorim detyre". Bëhet fjalë për Krenar Behari, i cili është arrestuar me urdhër të prokurorit Arjan Ndoji. Mësohet se Ndoji u kap mesditën e djeshme sepse ka arrestuar një person të pafajshëm dhe ka lënë të lirë dhunuesin e tij. Burime nga prokuroria e qytetit bregdetar dje bënë me dije se ish-shëf i Krimeve ka ndërhyrë në një konflikt mes dy vëllezërve në Durrës, por në vend që të arrestonte autorin e



Krenar Behari

dhunës, ka prangosur viktimën. Ngjarja u zbulua pak ditë më parë gjatë marrjes në pyetje të të arrestuarit, i cili i tregoi shenjat e mëdha që kishte në trup. Sipas burimeve të mësipërme, personi i lënduar ka deklaruar se ishte arrestuar ai në vend të vëllait që e kishte sulmuar. "Është vëllai ai që

ka ushtruar dhunë ndaj meje, ndaj e denoncova në polici. Por shëf i krimeve nuk arrestoi vëllain tim, por më vuiri prangat mua. Unë i thashë që im vëlla do më vrasë dhe rrezikoj me jetë, por zyrtari i policisë më futi mua në burg që jam viktimë e dhunës. Ndërsa vëllai im dhunues është i lirë. Unë ju tregoj dhe shenjat e dhunës që kam në trup që ju të shikoni dhe verifikoni situatën. Gjithashtu, verifikoni vëllain tim, i cili nuk ka asnjë shenjë në trup, pasi është ai që më rrell", ka thënë i arrestuar, emri i të cilit nuk bëhet me dije. Pas verifikimit të deklaratave të dy vëllezërve dhe veprimeve të kryera (procesverbaleve) nga ana e shëfit të krimeve, Krenar Behari, prokuroria konkludoi se zyrtari i lartë i policisë kishte abuzuar me detyrë duke arrestuar personin e gabuar dhe favorizuar autorin e dhunës, i cili është i lirë. **kl.ha.**

"Gjyqtarja gënjeu tim bir, i tha që unë jam tezja. Eshtë e patolerueshme, të vihet në vend drejtësia!"

Kujdestaria e 7-vjeçarit, nëna: Ish-burri më dhunonte Ermira: S'më ka lejuar të kontaktoj me fëmijën prej 4 vitesh

Ina Allkanjari
Aradian Bushi

Ish-bashkëshorti ushtron te dhunë fizike dhe psikologjike ndaj meje. Nuk u largova me dëshirën time nga Shqipëria, sapo arrita në Belgjikë, Bledari më telefonoi dhe më tha që mos të guxoja të vija të takoja djalin", kështu është shprehur dje për "Gazeta Shqiptare", nëna e fëmijës 7-vjeçar që është bërë "mollë shëri" mes dy prindërve. Reagimi i saj ka ardhur një ditë pas intervistës që "GSH" realizoi me ish-bashkëshortin e saj, Bledar Ara. Në një intervistë ekskluzive për "Gazeta Shqiptare", mamaja e Renisit (fëmijës 7-vjeçar), Ermira Nurja ka shprehur shqetësimin në lidhje me fatin e fëmijës dhe të pathënat e ish-bashkëshortit të saj.



Nëna e fëmijës, Ermira Nurja

Sa herë keni kontaktuar me djalin tuaj që prej largimit nga Shqipëria?

Gjithsej kam kontaktuar vetëm dy herë me djalin tim dhe kjo vetëm në rastin kur dhe kanë bërë të mundur psikologët ekspertë të caktuar nga gjykata. Unë i kam paraqitur gjykatës provat që Bledari nuk më lejon të takoj djalin tim, qoftë edhe nëpërmjet skyp-it, fakt i cili u vërtetua edhe nga gjyqtarët e Apelit Shkodër. Të cilët në momentin që gjyqtarja pyeti djalin se si e ka emrin nëna, ai nuk më njohte. I padjallëzuar, ai tregoi se për nënë njihje bashkëjetuesen e të atit. Mu shembet tokë nën këmbë në atë moment. E kisha shumë të vështirë të përballoj këtë dhimbje. Ajo që ishte më e pa tolerueshme, ishte fakti që gjyqtarja i thoshte për mua që unë jam tezja. Nuk di se si drejtësia funksionon kështu?

A e keni bërë divorcin?

Po. Divorci është bërë që në vitin 2014 dhe është kërkuar nga Bledari gjë, që vërtetohet që unë nuk kam pasur qellim të prish familjen megjithëse ndihesha e izoluar dhe e dhunuar. Unë vazhdoj të jem vetëm dhe gjithë përpjekjet e mia i bëj vetëm të shoh fëmijën tim që ma mohan pa të drejtë Bledari. Përkundrazi është Bledari ai, i cili ka krijuar një bashkëjetese prej disa vitesh. Uroj të jetë martesë e fundit për të, sepse ai është martuar tri herë.


Përpara disa ditësh keni bërë një denoncim në media që djali juaj është pyetur në ambientet e shkollës nga gjyqtarët?

Po, sapo u informova për këtë vendim të gjykatës, kontaktova median, e cila mori në konsideratë shqetësimin tim, duke e bërë publike, pasi nuk kam mundësi ku të dëg-

johet tjetër zëri im, sepse Bledari më ka mbyllur çdo urë komunikimi me fëmijën tim dhe përpjetat ta paraqesë situatën sikur jam unë që kam braktisur fëmijën. Mund t'iu vë në dispozicion disa video ku jam përpjekur t'i kërkoj Bledarit që të më lejojë të komunikoj me djalin, por ai nuk pranon. Të njëjtën kërkesë ia kam bërë edhe ish-vjehrrës time dhe ajo nuk ka pranuar, gjithashtu.

Kur kanë filluar përpjekjet tuaja për marrjen e fëmijës?

Përpjekjet dhe mundimet e mia kanë filluar që në vitin 2014, kur është bërë divorci. Fillimisht Gjykata e Shkallës së Parë në Shkodër vendosi që kujdestarinë e fëmijës ta kishte Bledari dhe unë të komunikoj me fëmijën me skype, dhe fëmija të vinte gjatë muajve të verës atje ku



Faksimile e vendimit të gjykatës

jetoja unë. Kjo nuk u bë e mundur asnjëherë. Në këto kushte i drejtohem përsëri gjykatës për ndryshim të vendimit të mëparshëm, në lidhje me pjesën e kujdestarisë së fëmijës. Gjykata e Shkallës së Parë, Shkodër mori në shqyrtim çështjen dhe vendosi që kujdestaria e fëmijës të më kalonte mua, kjo bazuar në faktin që Bledari nuk e ekzekutoi asnjëherë vendimin e gjykatës. Gjithashtu, edhe mbi bazën që interesi më i lartë i fëmijës, rekomanduar nga psikologët ishte që djali të qëndronte me mua. Këtë vendim të gjykatës së Shkallës së parë e ankmoi Bledari dhe kështu nisi gjyqi përsëri në Gjykatën e Apelit, e cila pas 10 seancave gjyqësore vendos me kërkesë të avokatit mbrojtës të Bledarit që të pyesë djalin në ambientet e shkollës pa prezencën e avokates sime. Kjo ndodhi duke e ditur që djali kishte tre vjet e gjysmë që ndodhë në efektin e propagandës së babait, që në çdo moment më paraqet sikur ta kem braktisur atë.

Ka marrë vendim gjykatës?

Fatqësisht po, për mua vendimi u mor, që në momen-

tin që gjykata pranoi kërkesën e avokatit të Bledarit për ta pyetur fëmijën në shkollë, në një kohë që është vetëm 7 vjeç. Edhe pse ishte përgatitur një raport vlerësimi nga tre psikologë, të cilat erdhën në Belgjikë, panë kushtet e mia dhe në mënyrë unanime vendosën që kujdestaria e djalit të më ngelej mua. Nuk e kuptoj dot se çfarë mund të thotë një djalë 7 vjeç që ka vetëm 1 muaj, që ka filluar shkollën dhe në prezencë të mësueses kujdestare dhe të tre psikologëve të shkollës dhe të tre panjohurve (gjyqtarët dhe sekretarja) në kushtet që i është mohuar plotësisht e drejta për të njohur nënën e vet. Gjykata nuk ka marrë parasysh faktin që unë jam me status azilanti në Belgjikë, dhe nuk mundem të udhëtoj në Shqipëri për aq kohë sa nuk kam mjet identifikimi për udhëtim. Në këtë mënyrë ky vendim, të cilin e kam diskutuar edhe me ekspertë të Belgjikë rezultoi të jetë jo efektiv dhe nuk mundëson realizimin e së drejtës sime dhe të djalit për t'u takuar.

Çfarë thuhet në vendim?

Vendimi thotë që duhet të vij fizikisht të marr djalin në një kohë që vendimi i më-



BLEDAR ARA, BABAI I FËMIJËS

"Ermira e braktisi fëmijën tonë që në moshën 2 vjeç e gjysmë, në dhjetor djali bën 7 vjeç. Kam rreth 4 vite që e ris dhe e edukoj i vetëm. Mamaja e tij u largua dhe nuk ka ardhur asnjëherë ta shohë djalin. I preva biletën që të qëndronte 15 ditë pranë të afërmeve të saj, por ajo nuk u kthye më", - është shprehur për "GSH", dy ditë më parë ish-bashkëshorti i Ermirës.

parshëm cilësonte qartë që djalin mund ta merrja gjatë verës dhe ai mund të sillej në Belgjikë nga daja i vet, i cili do pajisej sipas ligjit me prokurë.

Si e përballoni jetesën në Belgjikë?

Punoj si nëpunës në një qendër sociale në Belgjikë dhe kam filluar studimet e larta për punonjëse sociale. Kam të ardhura të qëndrueshme dhe përpjekjet e mia për marrjen e djalit nuk do të përfundojnë asnjëherë. Dita e parë që unë do të marr dokumentet belge, do vij të takoj djalin tim edhe pse më rrezikohet jeta.

TIRANË - Një 30-vjeçar nga Librazhdi ka rënë në pranga pasditen e të enjtes nga policia e Tiranës, pasi iu gjetën dy mina me telekomandë, si dhe një sasi e konsiderueshme kokainë. Bëhet fjalë për Taulant Goli, i cili mësohet të ketë qenë nën hetim prej disa javësh nga oficerët e Krimeve të Komisarariatit nr.6, pasi dyshohej për lidhje me veprimtari kriminale dhe me rrezikshmëri të lartë. Sipas policisë Goli ishte një person me priurë radikale dhe kishte krijuar dyshime në lëvizjet e tij, herë pas here ai është parë në zonat periferike të Tiranës. Operacioni për arrestimin e të dyshuarit u organizua ditën e enjte rreth orës 16:30, pranë një lokali në zonën e Unazës së Re, në Tiranë. Në momentin që Goli ka konstatuar prezencën e policisë, ka

Dyshohej për veprimtari kriminale, nën hetim prej javësh nga oficerët e Krimeve

Kapet me 2 mina artizanale me telekomandë dhe disa gramë kokainë, në pranga 30-vjeçari



Taulant Goli

tentuar të largohet, por uniformat blu arritën të kapnin në flagrancë të riun. Mësohet se forcat policore kishin marrë informacion se 30-vjeçari mbante sende të jashtëligjshme me vete. Pas arrestimit në një çantë që Goli mbante me vete iu gjetën dy bombat me eksploziv D4, të montuara me celular, si

dhe disa doza lëndë narkotike e llojit kokainë, me peshë totale rreth 30 gramë dhe dy karta telefoni, të cilat iu sekuestruan në cilësinë e provës materiale.

HETIMI

Taulant Goli dyshohet se është një person me rrezikshmëri të lartë, prej disa javësh oficerët e Krimeve të Komisarariatit nr.6 kishin siguruar informacione operative në lidhje me veprimtari kriminale të tij. Dy minat e sekuestruara, të cilat ishin të lidhura me aparat celular për shpërthim në distancë, të përgatitura në mënyrë artizanale me lëndë plasëse ni-

trat amoni, dyshohet se do të përdorshin për ngjarje të rënda kriminale. Një minë e tillë, në tregun kriminal mund ta sigurosh për një shumë që varion nga 3 deri në 4 mijë euro. Pas arrestimit, 30 vjeçari nuk ka pranuar që të flasë për grupin hetimor, duke mos dhënë sqarime se për çfarë do të përdorej lëndja plasëse që iu kap në flagrancë. Taulant Goli nga fshati Zdrash-Vërrri i Librazhdit, akuzohet për veprat penale "Mbjajtje pa leje e armëve, bombave apo minave ose lëndëve plasëse" dhe "Prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike". in.all

Manastirliu: Procs transparent sipas Kodit të Punës

Testohen me shkrim 75 aplikues për pozicionin "Drejtes" në 16 spitale

Plot 75 aplikantë iu nënshtruan dje testimit me shkrim për përzgjedhjen e drejtuesve në spitalet Universitare dhe Rajonale në vend. Në Tiranë, konkurrenca 22 kandidatë për postet e lira në 5 spitalet Universitare, ndërsa 53 të tjerë u testuan për pozicionet drejtuese në 11 spitalet rajonale. E pranishme në këtë fazë të konkurrimit ishte dhe ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu, e cila ndoqi nga afër testimin. "Është hera e parë që zhvillohet një konkurs i tillë, publik, transparent për drejtuesit e shëndetësisë në vend. Ky është një standard i ri, një model i ri dhe tashmë nuk ka më kthim mbropa, por çdo konkurs do të zhvillohet mbi bazë meritokracie dhe mbi baza të procedurave transparente", tha ministrja. Për përzgjedhjen e tyre, aplikantët për pozicionin "drejtor" në spitalet universitare apo rajonale, duhet të kalojnë në tri faza testimi.

MINISTRJA

"Është hera e parë që zhvillohet një konkurs i tillë, publik, transparent për drejtuesit e shëndetësisë në vend. Ky është një standard i ri, një model i ri dhe tashmë nuk ka më kthim mbropa, por çdo konkurs do të zhvillohet mbi bazë meritokracie dhe mbi baza të procedurave transparente"

është një standard i ri, një model i ri dhe tashmë nuk ka më kthim mbropa, por çdo konkurs do të zhvillohet mbi bazë meritokracie dhe mbi baza të procedurave trans-

parente", tha ministrja. Për përzgjedhjen e tyre, aplikantët për pozicionin "drejtor" në spitalet universitare apo rajonale, duhet të kalojnë në tri faza testimi.

Faza e parë ishte ajo e aplikimeve ku 84 kandidatët konkurruan me dosje dhe u përzgjedhën në bazë të kri-tereve. Prej tyre, vetëm 75 kaluan në fazën e dytë, atë të testimit me shkrim. Më tej, në fazën e tretë, një komision i posaçëm do të zhvillojë testimin me gojë të aplikantëve. "Tashmë është nguritur komisioni ad-hoc, i përbërë nga ekspertët të shëndetësisë dhe menaxhimit në Shqipëri si dhe ekspertë ndërkombëtarë të menaxhimit spitalor që do të bëjnë




Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ogerta Manastirliu, vlerësimin e aplikantëve në fazën e tretë, theksoi Manastirliu. Gjatë provimit u konstatua edhe prezenca e drejtorëve aktual të 5 spitaleve universitare, që nuk janë dorëhequr dhe as shkarkuar nga detyra. Por ministria deklaroi se procesi është transparent dhe në përputhje me kodin e punës dhe legjislacionin në fuqi.

Këshilli Rinor i Ambasadës Amerikane: 43% e studentëve konstatojnë sjellje abuzive

Alarmi/ Korrupsion në universitete

Studimi: Pedagogët marrin rryshfete në këmbim të notës

Korrupsioni vazhdon të mbetet një problem madhor në universitetet shqiptare, kjo në bazë të një studimi të realizuar me 990 studentë, nga Këshilli Rinor i Ambasadës Amerikane. Sipas të dhënave të publikuara, më shumë se gjysma e studentëve të Universitetit të Tiranës, e shohin korrupsionin si një faktor pengues për rininë në vend dhe familjet e tyre. Rreth 43% e të anketuarve pohojnë se në fakultetin ku vazhdojnë studimet e larta është i pranishëm korrupsioni i dëshmuar nëpërmjet ndërhyrjeve abuzive nga një palë e tretë, të afërm apo familjarë. Ndërsa rryshfeti është forma direkte e demonstrimit të abuzimeve nga pedagogët. "Bazuar në përvojat personale të studentëve, pjesa më e madhe e rasteve abuzive në fakultet kanë të bëjnë me favorizimin lidhur me vlerësimin për lëndën (64%). Në rend të dytë vjen marrja e lëndës për frekuentim", theksohet në raportin e Këshillit Rinor të Ambasa-



dës Amerikane të përgatitur nga Edmon Çera. Raporti tregon se pedagogët ushtojnë presion psikologjik ndaj të rinjve, të cilët e përjetojnë periudhën e sezonit me frikë e pasiguri. Rezultatet e publikuara paraqiten me 3 pikë më shumë se Indeksi Kombëtar i Korrupsionit, çka tregon se duhet të ngrihet alarmi për mënyrën si funksionon sistemi i lartë arsimor në Shqipëri. 53% e studentëve kërkoi krijimin e një portali apo aplikacioni ku të adresojnë ankimmimet e tyre, si një zgjidhje për këtë "ngërc" që ka përfshirë fakultetet.

ANKIMIMI

Ndërkaq, rreth gjysma e studentëve në këtë universitet deklaroi se nuk kanë informacion nëse në departamentet e tyre ka një zyrë përkatëse në të cilën mund të drejtohen në rastet kur konstatohen forma abuzive apo sjellje korruptive nga ana e pedagogëve apo pjesës tjetër të stafit. Por në përgjithësi, 3 në katër studentët, deklaroi gjatë intervistave se kanë pak ose aspak informacion për kuadrin ligjor shqiptar dhe detyrimet ndërkombëtare në luftën kundër korrupsionit. "Gati 13% e studentëve të Universitetit të Tiranës po-

hojnë se Kodi i Etikës nuk respektohet në fakultetin e tyre, për më shumë rreth 5% e studentëve thonë se ky kod jo vetëm që nuk respektohet, por madje as nuk ekziston", citohet në raport. Në bazë të raportit, të rinjtë besojnë se sistemi arsimor, mediat dhe udhëheqësit politikë duhet të marrin në shumë përgjegjësi për të rritur rolin e tyre në luftën kundër korrupsionit. Ndërkohë, sistemi gjyqësor, qeveria dhe opozita perceptohen nga ana e studentëve si instancat më abuzive në vend, të pasuara nga sistemi i shëndetësisë që vlerësohet me plot 84 pikë për sa i përket korrupsionit në Shqipëri.

43% STUDENTËT

Rreth 43% e të anketuarve pohojnë se në fakultetin ku vazhdojnë studimet e larta është i pranishëm korrupsioni i dëshmuar nëpërmjet ndërhyrjeve abuzive nga një palë e tretë, të afërm apo familjarë. Ndërsa rryshfeti është forma direkte e demonstrimit të abuzimeve nga pedagogët. Pjesa dërrmuese e studentëve të Universitetit të Tiranës mendojnë se "Kemi të bëjmë me një rast aspak të përshtatshëm dhe aspak të justifikuar kur pedagogu pranon dhuratë apo rryshfet nga studenti".

Shuhet prof. Tika Theodhosi, simboli i kirurgjisë shqiptare

Është ndarë nga jeta në moshën 95-vjeçare, personazhi i Mjekësisë Shqiptare, prof. Tika Theodhosi. Ai mbetet simboli i kirurgjisë, i shquar për saktësi absolute në përcaktimin e saktë të diagnozave. I ndjeri do të prehet në vendlindjen e tij, Korçë, sipas amanetit të lënë. Tika është themeluesi i Onkologjisë Moderne Shqiptare. Pjesëmarrja në shumë Konferenca Ndërkombëtare dhe specializimet e ndryshme jashtë vendit bënë që Prof. Tika Theodhosi të ngrinte Statistikën Onkologjike në Shqipëri. Lindur në Korçë në vitin 1922 dhe diplomuar në Liceun e Korçës, Tika do të fillonte studimet e tij në Mjekësi në Zagreb për t'i përmbyllur ato në Moskë. Mbi filozofinë e tij, ai diktohet faktin që mjekësia mësohet tek shtrati i të sëmurit, duke i qëndruar pranë dhe duke e vëzhguar dhe duke pritur çastin e duhur për të kryer ndërhyrjen kirurgjikale. Kështu Tika ndërtoi të gjithë karrierën e tij 40-vjeçare profesionale. Ai organizoi simpoziume për kancerin e gjirit dhe bashkë me kolegët e tjerë ngritën Kabinetin e Kyriterapisë, i cili vazhdon edhe sot.

Instituti për Ruajtjen e Natyrës, takim për mbrojtjen e mjedisit

Instituti për Ruajtjen e Natyrës organizoi tryezën e lrrumbullakët me përfaqësuesit e mediave dhe gazetarët. Gjatë këtij takimi u diskutua mbi projektin që ka për qëllim të nxisë dhe të mundësojë një mjedis ligjor dhe financiar për shoqëri civile dhe media pluraliste, si dhe fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile dhe medias për të qenë aktor të pavarur efikas dhe të përgjegjshëm. Projekti ka përgatitur raportin e analizës së thelluar të kuadrin ligjor dhe institucional për zbatimin e procedurave të vlerësimit të ndikimit në mjedis. Gjithashtu, projekti ka përzgjedhur dhe disa shembuj të zbatimit të procedurave të transparencës, informimit të publikut si dhe VNM/VSM në vendet e zhvilluara dhe ato në zhvillim me synimin e prezantimit të këtyre shembujve si praktika të mira. Duke u nisur nga rëndësia e këtyre problemeve, INCA si partner e këtij projekti, nxitë sjelljen proaktive të medias dhe shkruara dhe vizive në procesin e VNM/VSM. Gjithashtu, u vendos theksi mbi investimet e qëndrueshme në dobi të ekonomisë dhe mjedisit.

STRATI Shoqëria përmbarimore "STRATI BAILIFFS SERVICE" Sh.p.k., ofron shpalljen për shpalljen në ankand të pasurisë të pajaljuar:

- "Trull", me sipërfaqe 3200 m², ndodhur në Shëngjin, Lezhë, Zona Kadastrale 3126, regjistruar në Regjistrin Hipotekor me nr. 13, datë 31.01.2006, në pronësi të Shoqërisë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a., lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipotekë Nr. 449 Rep., Nr. 21/3 Kol., datë 02.02.2006. Çmimi fillestar i ankandit është 89,600 Euro;

- "Trull" së bashku me depozitë karburanti, me sipërfaqe 4419 m², ndodhur në Shëngjin, Lezhë, Zona Kadastrale 3126, regjistruar në Regjistrin Hipotekor me nr. 14, datë 31.01.2006, në pronësi të Shoqërisë "Taçi Oil International Trading & Supply Company" sh.a., lënë si garanci hipotekore për Bankën me Kontratë Hipotekë Nr. 448 Rep., Nr. 21/3 Kol., datë 02.02.2006. Çmimi fillestar i ankandit është 162,036 Euro.

Ankandit për pasuritë e mësipërme zhvillohet në datë 06.11.2017. Ankandit për pasuritë e mësipërme zhvillohet në ora 16.00, në ambientet e Shoqërisë Përmbarimore "Strati Bailiff's Service", Rruga "Jordan Misja", Pall. 141/1, Shkalla 1, Ap. 7, Tiranë. Tel: 04 45 00 450, www.stratibailiff.com, info@stratibailiff.com

AKADEMIA

Fatmira Nikolli

Ndonëse po bëhen dy muaj nga zgjedhja e kryetarit të ri të Akademisë së Shkencave

në një proces të rregull ligjor, por tejet të debatuar, Gudar Beqiraj ende nuk është dekretuar nga presidenti i Republikës. Pas lajmit në media se Presidenti Ilir Meta nuk do ta dekretonte për shkak të procedurave, burime nga presidenca thonë se ligji nuk ka parashikuar një afat për dekretimin, ndaj edhe momentalisht nuk ka një vendim. Vetë prof. Beqiraj në një intervistë për "Gazeta Shqiptare" thotë se asgjë nuk mundet ta pengojë dhe se zgjedhja e tij është bërë sipas statutit dhe ligjit për Akademinë e Shkencave të Shqipërisë. Nga Budapesti ku ndodhet për një takim me Presidentin e Federatës Botërore të Peshëngritjes, Gudar Beqiraj (në mandatin e tij të dytë si kryetar) sqaron procedurën ligjore dhe njohten e hershme me presidentin Ilir Meta, në kohët kur edhe ai i qe kushtuar peshëngritjes dhe ishte nxënës i kryetarit të padekretuar të Akademisë së Shkencave. Fakt është që nuk ka një afat të mirëfilltë që e detyron presidentin të dekretojë ose jo një emër. Interesim të "GSH" se çfarë ndodh në rast se presidenti nuk e dekreton kryetarin, burimet u përgjigjen se kjo çon në mbledhje të asamblesë së Akademisë që vendos për zgjedhje të reja ose çdo vendimmarrje tjetër. Të njëjtat burime shtojnë se detyra e presidentit mbështetur në nenin 92 të Kushtetutës është që të emërojë Kryetarin e Akademisë së Shkencave.

Prej vitit 2009, dy janë emrat që kanë bërë rotacion në drejtimin e ASH-së, Gudar Beqiraj kryetar e Muzafër Korkuti nënkryetar dhe e anasjella. Kur të njëjtët emra u përsëritën edhe sivjet, Artan Fuga hapi një debat duke e quajtur farsë procesin, deklarata që kërkoi vëmendjen e kryeministrit Rama, duke bërë që ky i fundit të "kërcënohte" publikisht për prerje fondesh nëse nuk ndalej farsa. Por, "farsa" siç do ta quante kryeministri nuk u ndal, sepse fakti është që nuk kish emra të tjerë të interesuar për të drejtuar akademinë. Pas zgjedhjes së Beqirajt në krye të Akademisë dhe Korkutit si zëvendës i tij, ky i fundit dha dorëheqjen për shkak të presionit publik, ndërsa Beqiraj vijoi punën "pa të drejtë firme", siç mund të cilësohet kryesimi i tij pa një dekret nga presidenti.

Prej katër vitesh ka tri propozime që presin për reformën (akademii me institute dhe me dy seksione të mëdha - seksionin e shkencave biologjike dhe seksionin e shkencave tekniko-naturore; akademii me institutet analojkike ose akademii pa institute). Mediat thanë dhe se,

Përplasja mes Presidencës dhe Akademisë: Beqiraj: Lidhja ime me Metën, ja ç'po ndodh

Qeveria i heq buxhetin/ Kryetari i Akademisë së Shkencave i padekretuar nga Meta, Gudar Beqiraj: Pengohet reforma



Në foto: Gudar Beqiraj



Në foto: Presidenti Ilir Meta

SITUATA

Dy muaj debat dhe një kryetar i padekretuar jo vetëm që kanë lënë procesin e reformimit në mes, por kanë penguar edhe vijimësinë normale të punës. Ndërsa kryetari është në duart e presidentit, mbarëvajtja e punëve në Akademi mbikëqyret nga sekretari, Vasil Tole

pse në projektbuxhetin e vitit 2018 ishte parashikuar shuma prej 110.5 mln lekësh për institucionin e Akademisë së Shkencave, këtë të premte, kryeministri Edi Rama gjatë mbledhjes së qeverisë ka kërkuar që ky fond t'i kalojë Ministrisë së Arsimit, e cila më pas do ta vendosë në dispozicion të universiteteve për kërkim shkencor.

Më poshtë intervista me prof. Gudar Beqiraj.

- A ka një afat ligjor për dekretimin nga ana e presidentit?

Nuk ka afat ligjor, ndaj e kanë zgjidhur. Në ua kemi kërkuar edhe me shkresë tjetër zyrtare, para disa ditësh që të na japin një përgjigje, sepse i duhet institucioni. Unë jam i zgjedhur, mua nuk kanë ç'të më bëjnë. Dekretimi është një moment i tillë që shikohen procedurat e bëhet dekretimi. Ndërkohë që në procedurat i kemi super të sakta. Ajo që ka dalë sot (dje) që nuk ka pasur kandidaturë, ajo nuk qëndron, sepse ne as në statusit, as në ligj nuk e kemi. Ne u themi të gjithëve: kandido. Nëse kandidojnë 10 vota, 10 vota do të hidhen valla, edhe nëse kandidon vetëm një, është njësoj. Nuk ka asnjë ndryshim. Nuk ka asnjë kusht në ligj, as në statut. Ne zbatojmë ligjin dhe statutin,

nuk ka kusht që të ketë dy a më shumë kandidatë. Është tjetër gjë, që çdo akademik ka të drejtë të zgjidhet në një post të caktuar drejtues, dy herë por jo radhazi. Ky është kushti, edhe këtë e kemi zbatuar, ashtu sikundër kushtet e tjera. Më e bukura është se ne i kemi bërë zgjedhjet me 20 kamera duke na vëzhguar.

- Çfarë shkresash keni dërguar presidentit?

Së pari, direkt pasi u zgjidha unë më datën katër, në në datë 6, siç e kërkon procedura, i kemi dërguar Presidencës, me një shpjegim të së gjithë procedurës së zgjedhjes, kërkesa për dekretim sipas ligjit dhe e ka në Kushtetutë që duhet ta dekretojë. E kemi dërguar duke bërë gjithë shpjegimin e nevojshëm për të gjithë procedurën. Më pas, para dy-tri ditësh, ne kemi dërguar një shkresë tjetër, ku themi që na është vuuar shumë dekretimi dhe për këtë arsye nuk po bëjmë dot dekretime, sepse titullarit nuk ka të drejtën e firmës. Pavarësisht se unë kam qenë gjatë gjithë kohës në punë, në zyrë. Sepse nuk ka ndonjë kusht që mua të më kërkohet të iki nga puna derisa të bëhet dekretimi.

- Si është vepruar më herët nga presidentët?

Ka një precedent. Pavarësisht kush është president, Presidenca ka një standard si institucion. Në zgjedhjet e mëparshme, edhe kryetari, edhe nënkryetari janë votuar e dekretuar duke qenë kandidatë e vetme. Kryetari i Akademisë është dekretuar menjëherë nga ish-presidenti i Bujar Nishani. Nëse ka ndonjë argument tjetër, ose ndonjë arsyetim tjetër do të sqarohet, por nga Presidenca, me sa di unë nuk ka asgjë tjetër. Unë jam në Budapest dhe në ditë të tilla nuk ka asgjë tjetër.

- A keni një njohje personale me Presidentin Meta, mbase nga peshëngritja?

Jo vetëm që kam njohje me presidentin, por unë kam njohje shumë të thellë me të. Sepse ka qenë student i imi, ka qenë peshëngritës i imi. Ka shumë vajza e djem që më thonë se je babai i peshëngritjes dhe nga ana tjetër, kam njohur miqësi të mirë edhe me kryeministrin. Në vitin 2000 ne kemi bashkëpunuar fuqishëm për Olimpiadën e Sidneit, kur ka qenë ministër i Kulturës. Pra, kemi bashkëpunuar dhe jemi ndarë mirë.

- Ky mosdekretim i juaji, sa e pengon reformimin e Akademisë së Shkencave?

Po si nuk e pengon? Unë nuk firmos dot dhe nuk bëj dot asnjë gjë. Unë vërtet jam prezent në Akademi se kam të drejtën time se jam zgjedhur, brenda rregullave, statutit dhe ligjit për Akademinë e Shkencave. Kryetari duhet të dekretohet dhe precedenti është se nga një kandidaturore kanë qenë edhe para katër vitesh kur janë zgjedhur. Nuk ka pse ngrihet ky problem, sepse e ngre tjetrin problem vetëm nëse ke shkelur ligjin a procedurat, ndërsa në këtë rast jemi konform të gjithëve.

- Pse ndodhemi në Budapest?

Sapo kam marrë një lajm shumë të madh për Shqipërinë, se kemi bashkë me presidentin e Federatës Shqiptare të Peshëngritjes, kemi ardhur për një takim pune me presidentin e Federatës Botërore të Peshëngritjes dhe na ka konfirmuar mbështetjen e fuqishme për të marrë një kampionat botëror e për ta zhvilluar në Shqipëri. Unë me këtë po merrem tani.

FATMIRA NIKOLLI

Me interpretimin e Ema Andreas në rolin nënës dhe Matia Llupas në atë të birit, pjesa e shkruar nga Jon Fosse është një dramë e fortë psikologjike, që mbërrin deri te kompleksi i Edipit, me skena të forta, herë-herë edhe të rënda që zgjojnë ndërgjegjet e përgjumura njerëzore përmes gjuhës shprehëse të teatrit, trupave të aktorëve, lojës skenike dhe tekstit të fortë. Një shfaqje kundër shoqërive patriarkale e njëherit krejt larg teatrit tradicional apo atij "të realizimit socialist", pesha e imazheve përballë krijon një shkëlqim të fuqishme nga boata përreth, duke bërë të gjykohej ajo e të kërkohen rrugë të reja përjetimi e jetese, larg formalizmave të shoqërive të "mbytura" nga paragjykimet e mungesa e lirisë. Ema Andrea guxon sërish, jo vizualisht përmes shfaqjes së trupit, por edhe si artiste me rolin e fortë që ka marrë përsipër: "Nuk kemi kohë të ndalojmë dhe po humbasim dashurinë për nënën, miqtë, fëmijën, gruan. Ajo çfarë du ta them me këtë dramë është një temë e madhe, që e gjejmë jo vetëm në Ballkan, por në të gjithë botën. Pothuajse të gjithë ndjehemi si të burgosur. Me këtë shfaqje ngremë pyetje, shprehim idetë tona, shfaqim emocionin dhe idetë pozitive, sepse teatri nuk është vetëm një akt estetik, por edhe një akt social. Vetmia e njeriut është tema më e afërt e aktualitetit që po jetojmë. Ja, unë kam reflektuar: Sapo të mbarojë shfaqja kam menduar të marr nënën time në telefon". Regjisori i njohur Dino Mustafiç e shpjegon kështu dramën "Nëna dhe fëmija", që vjen këtë të shtunë në Qendrën Kulturorë "Tulla Center". Mustafiç duke folur për kar-

"NËNA DHE FËMIJA"

Shfaqja tronditëse, Ema Andrea zhvishet për një dramë të rëndë psikologjike

akteret e shfaqjes, shtoi se, "këta njerëz nuk janë të lumtur, sepse ritmi i jetës dhe morali i shoqërisë u ka bërë vrirna në trupat e tyre bosh dhe se për

këtë arsye, impulset e tyre në shfaqje kanë qenë të rënda. Gozhdoi shoqëritë edhe kur tha se meshkujt e grupeveve patriarkale janë mësuar të



do të shfaqet me një skenografi artistike nga Klod Dedja, koreografi nga Gjergj Prevazi, kostumografi të Berina Kokonës dhe muzikë të kompozuar nga Ilir Bajri. Skenari është bërë nga Zejlka Udoviciq Pestina, që na tregoi se ka përdorur një gjuhë poetike në funksion të konceptit modern të dramës. Jon Fosse është një nga shkrimtarët bashkëkohorë norvegjezë më të përkthyer dhe të interpretuar. Kritik të kanë cilësuar si një nga autorët më inteligjentë të dramës dhe letërsisë bashkëkohore.

Shfaqja "Nëna dhe fëmija" trajton njerëz që vuajnë nga izolimi total, vetmia dhe vështirësi komunikimi. Personazhet e Fosse-së janë të ngecur në mendimet e tyre dhe fjalët e tyre janë monologë, të cilët ndonjëherë kthehen në bashkëbisedim. Premiera është të shtunë për publikun, vazhdon të dielën në mbërme për të vijuar dhe net të tjerë. "Nëna dhe fëmija" do të vazhdojë edhe në muajin nëntor nga e hëna deri të enjten për publikun. Ata janë të burgosurit e përjetshëm, të cilët janë edhe aktorët e mirë. "Ka artistë të talentuar, që janë të plotë afësi parandjenje. Karakteret të Fosses janë të ngecur në mendimet e veta dhe prandaj fjalët të shprehura në fakt janë monologë, të cilët ndonjëherë shkaktojnë të bëhen komunikim. Atmosfera e sikletshme e tregon sekretin, i cili është i mbytur në të kaluarën dhe çdo komunikim është pak nostalgjik, zbulon ose mbetet i shtypur në egon e karakterit. Por në atë ndjesi melankolike dhe boshllëku as nëna, as fëmija ekzistencialisht nuk gjejnë qetësinë dhe heshtjen e dëshiruar, nuk janë në gjendje të bien në paqe me demonët (shpirttrat) personalë, të cilët i përndjekin."



Shkencëtare e së nesërme

E ardhmja
është emocionuese.

Ready?

 **vodafone**



FLUTURONI PER NE ROME DHE ÇDO DESTINACION TJETER ESHTË I ARRITSHËM FALE LIDHJEVE TONA. REZERVONI DERI NE 05 NENTOR

ROMA DUKE FILLUAR NGA	MADRID DUKE FILLUAR NGA	LOS ANGELES DUKE FILLUAR NGA
€119	€209	€619

VAJTJE-ARDHJE TE GJITHA TE PERFSHIRA



ALITALIA.COM | +355 4 2230023 | AGJENCITE E UDHETIMIT

Çmimet, janë subjekt i disponueshmërisë në klasa të caktuara të rezervimit; janë për klasa ekonomike për udhëtimin vajtje-ardhje; përfshijnë gjitha taksat dhe shërbimet për blerjet e biletave në alitalia.com. Tarifa shtesë mund të aplikohen nga kanale të tjera shitjeje. Oferta është e vlefshme për nisjet nga Tirana në destinacionet e përzgjedhura. Biletat duhet të blihen deri më 05 Nentor 2017. Detaje të plota mbi kufizimet e mundshme mund të gjenden në alitalia.com.



Mavrovë



Ski në Dëborë

Skijimi në Maqedoni është sport popullor që është i preferuar nga njerëzit lokal si dhe turistë të huaj. Maqedonia ofron kushtet të mira klimatike për sportin. Skijimet alpine dhe nordike janë ngjarje të mëdha që mbahen për të nxitur bukurinë e maleve të Maqedonisë. Ka dy ngjarje tradicionale që organizohen nga punëtorët e skive maqedonase: Turneu memorial i Mavrovës dhe Turneu ndërkombëtar i Skijimit Alpin i njohur edhe si Kupa e Malit Sharr që janë dy ngjarje sportive të njohura në Maqedoni të cilat janë të organizuara nga komuniteti Bistra dhe Popova Shapka. Sportelet e konvikteve të Skijimit në dëborë janë shumë të popullarizuara në Maqedoni. Ju mund të bëni ski në disa vende si: Mavrovo, Mali Sharr, Kozhuf, Pelister dhe Krushevë.

Opinion *i* Ditës

Të gjithë së bashku, për të përmbushur ëndrrën e Azemit

Nga Ilir Meta

(Vijon nga faqja e parë)

... dhe bashkëluftëtarë!
Është një kënaqësi e veçantë për mua, si President i Republikës t'ju falënderoj për ftesën në përurimin e shtatores të heroit të demokracisë, z. Azem Hajdarit!

Në pamundësi për të qenë bashkë me ju në këtë ceremoni nderimi, më lejoni së pari nëpërmjet këtij mesazhi t'ju përcjell vlerësimin tim më të lartë për aktivitetin dhe kontributin e tij historik si dhe të përgëzoj Bashkinë e Tropojës dhe gjithë ata që ndihmuan për ngritjen e kësaj përmendoreje.

Vendosja e monumentit të Azem Hajdarit në vendlindjen e tij të shtrenjtë është një gjest fisnik mirënjohjeje jo vetëm për kontributin e tij të pazakontë, por edhe për vlerat e shoqërore e kombëtare, që kjo vatër e patriotizmit ka mbajtur në shekuj!

Portreti i bashkëstudentit tonë të dhjetorit, heroit Azem Hajdari, nderon familjen e tij të dashur, Tropojën dhe të gjithë kombin shqiptar.

Ai do të ngelet përgjithmonë tribun popullor i dashur jo vetëm për demokratët, por edhe për shumë shqiptarë, pavarësisht bindjeve të tyre politike.

Në dhe brezat që do të vijnë do të kujtojnë Azemin si udhëheqësi i lëvizjes studentore, që i priu gjeneratës së re në betejën e tyre epokale për mposhtjen e diktaturës, për liri dhe demokraci, si dhe për një shoqëri të lirë!



Të nderuar miq,
Këto dekada në demokraci treguan se realizimi i aspiratës evropiane kërkon jo vetëm ideale dhe sakrificë për të mposhtur diktaturën, por njëkohësisht të njëj-

tin përkushtim edhe në ndërtimin e demokracisë, shtetit ligjor dhe ekonomisë së tregut.

Jam i bindur se nderimin më të merituar që mund t'i bënim emrit të Azem Hajdarit dhe idealeve që ai

udhëhoqi, do të ishin të punonim të gjithë së bashku për të përmbushur ëndrrën e tij dhe të gjeneratës që ai përfaqësoi, pra ta bëjmë Shqipërinë si e gjithë Evropa!

I paharruar përjetë kujtimi i tij!

HOROSKOPI

DASHI

Në punë çdo gjë do ju shkojë mirë dhe do të keni mundësinë të tregoni aftësitë. Do të ndërmerri një hap vendimtar për të zgjidhur një problem. Do të merrni një ndihmë të vazhdueshme, si shpirtërore ashtu edhe ekonomike, nga personat që ju duan të mirën.

DEMI

Hëna është në harmoni me Marsin, Merkurin, Uranin dhe Jupiterin. Priten surpriza të këndshme në punë. Ata që deri dje ju kundërshtonin, nga sot do t'ju mbështesin. Në dashuri mos u frikësoni nga përballjet sfiduese, nga disa probleme të brendshme do të dilni fitimtar.

BINJAKET

Vazhdon të ndjehet ndikimi i Saturnit që krijon kërcënime të vogla, duke frenuar dhe penguar herë pas here planet tuaja. Nëse ndjeheni të lodhur dhe të bezdisur, kërkon shoqërinë e një miqit dhe mendimet e zymta do t'zhdrukun shpejt.

GAFORJA

Do të keni ngadalësim të aktiviteteve që i keni për zemër, për shkak të problemeve dhe pengesave të bezdisshme. Mos u dekurajoni, do kalojë shpejt. Marsi vazhdon të jetë armiqësor ndaj jush. Kujdesuni për shëndetin dhe jini më të kujdesshëm se zakonisht.

LUANI

Mërkuri dhe Venusi në anën tuaj do t'ju ndihmojnë, duke garantuar rezultate shumë premtuese në punë dhe përvoja të bukura në jetën private. Nëse nuk jeni të lidhur, përgatituni për takime intriguese, planeti i dashurisë po thur plane për ju.

VIRGJERESHA

Të jetosh jetën në mënyrë konkrete nuk do të thotë të mos keni ëndrra në sirtar, për t'i nxjerrë pikërisht në momentin e duhur. Mos i merrni shumë seriozisht disa fjalë që ju janë thënë në një moment acarimi. Jini më lartë se kaq.

PESHORJA

Keni pak lodhje, që duhet të kaloni me ushqim të pasur me energji dhe të shëndetshëm si mjalti dhe çokolata. Do të rigjieni entuziazmin e humbur, duke menduar për një detyrë të rëndësishme, që me shumë mundësi do t'u besohet juve.

AKREPI

Mundësi për zhvendosje edhe të shkurtra nuk do t'ju vënë përpara vështirësive, por do t'i japin ngjyra aventurash të reja gjithçkaje që do të realizoni. Ju nuk duhet të bëni gjë tjetër veçse të ndiqni rrymën, duke mos u kthyer mbrapsht për asnjë arsye në botë.

SHIGJETARI

Forca e vullnetit për të luftuar kundër gjërave pa rëndësi po rëshet. Prandaj, më mirë të ndaleni dhe të shikoni se çfarë bëhet përreth përpara. Nga njëra anë ndiheni të përjashtuar e kështu doni të çlirohëni, nga ana tjetër kanë dëshirë t'i mbathni me të katra.

BRICJAPI

Jupiteri vazhdon t'ju mbështesë, duke ju sjellë entuziazëm dhe duke favorizuar perspektiva pozitive. Do të përjetoni momente emocionuese me partnerin e juaj. Është mirë t'ju jepen rëndësi anëve praktike të jetës së përditshme dhe rezultateve konkrete.

UJORI

Planetët ju këshillojnë të vetëpërbaheni, në mënyrë që të mbani për vete disa sekrete. Tu hapeni të tjerëve gjithandaj nuk do të ishte gjë e zgjuar. Mund të konstatojmë se besimi që keni tek disa persona të njohur së fundmi nuk ka qenë i arsyeshëm.

PESHQIT

Grindjet dhe sherrat mund të jenë gjëra që priten, por ju me urtësi do t'i mënjaroni shoqërimet me persona që ju shkaktojnë tensione dhe stres. Përfitoni nga përvoja për të mos bërë të njëjtat gabime si në të kaluarën.

BalkanWeb.com

AGJENCIA E LAJMEVE MË E KLIKUAR NË HAPËSIRËN SHQIPTARE. LAJMET MË TË FUNDIT ME VIDEO DHE FOTO NGA VENDNGJARJA, ANALIZA DHE TEMATIKA TË NDRYSHME, GJITHÇKA ME NJË KLIKIM.

MERRNI NE KOHE REALE LAJMET E FUNDIT NE APARATIN TUAJ

INSTALONI APLIKACIONIN E BALKANWEB NE MOBILE DHE TABLET

KERKONI NE APPLE STORE DHE GOOGLE PLAY OSE DUKE SKANUAR QR CODE APPLE DHE ANDROID

FALAS




BLUE TOOTH

Thashetheme
MADE IN ALBANIA

Nr. 582

SUPLEMENT I PERJAVSHEM GAZETA SHQIPTARE Redaktore: Enida Himaj - Art Designer: Nevila Samarxhi

E shtunë 28 Tetor 2017



2017, VITI I SHTATZENIVE,
JA SI DUKEN MAMATE VIP

ZAIMINA VASJARI

Zbulohet jeta e mëparshme e partnerit



**KUSH ËSHTE
BIZNESMENI
NGA DURRESI,
QE I KA RREMBYER
ZEMREN BUKUROSHES
SHQIPTARE**

*Babai i një
vajze dhe
marrëdhënia
13- vjeçare me
seksbombën
brune*

Rrëfehet modelja: Familja është çetësia dhe ilaçi i shpirtit për mua

XHENI BUSHI:

Xheni Bushi: Ju rrëfej vështirësitë që ka modelingu në Shqipëri



ONI HYSENBELLIU

sjell në Shqipëri seks simbolin Pamela Anderson, jeta dhe pasionet e biznesmenit

2017, viti i shtatzënive, ja si duken mamatë VIP

Pamela Allaj

Ky vit ka qenë i mbushur plot surpriza për VIP-at tanë. Shumë evenimente të rëndësishme janë bërë dhe sidomos shumë celebrime. Por nuk janë mjaftuar vetëm me këto, bukuroshet VIP, këtë vit kanë qenë të shumta ato që kanë sjellë për ndjekësit e tyre lajmin e lumtur të pritjes së një fëmije, për t'u bërë nënë për herë të parë apo edhe të dytë. Një lajm i tillë ka bërë që portalet t'i sjellin në qendër të vëmendjes, dhe pse jo, t'i "ndjekin" edhe gjatë shtatzënisë së tyre. Dhe nuk janë pak mamatë VIP për këtë vit. Le të shohim sa prej tyre kanë ndryshuar me kalimin e kohës që kur kanë mësuar se do të bëhen nëna.

FLORIANA GARO

Bukuroshja e "Jo vetëm modë", pas fejesës me avokatin zviceran, vendosi t'i largohej ekranit dhe jo shumë më vonë ishte ajo vetë që lajmëroi fansat e saj për faktin se priste një fëmijë. Ajo ka qenë gjithmonë e rezervuar lidhur me jetën e saj private dhe nuk ka dhënë shumë detaje lidhur me bashkëjetesën e saj me Enisin në Zvicër, apo edhe lidhur me vendimin e saj për t'u larguar përfundimisht nga televizioni. Por ajo nuk është shkëputur përfundimisht me ndjekësit e saj, ajo poston herë pas here në faqen e saj në "Instagram" foto nga momente të saj të veçanta të kaluara në Zvicër. Ende është herët për të thënë se ka një ndryshim në pamjen e saj, sepse është vetëm fillimi dhe ende s'mund të themi as se çfarë gjinie është bebja. Por, gjithsesi mund të themi se si më parë edhe tani Floriana mbetet e bukur dhe plot nur.

AMI MAMAQI

Ajo është në pritje të fëmijës së dytë tanimë. Si Floriana, edhe Ami së bashku me Ermalin vendosi ta jepte lajmin e mirë nëpërmjet një postimi në faqen e saj të "Instagramit". Dhe për t'i bërë akoma më të besueshëm në atë që thoshin, çifti Mamaqi vendosi të nxirrin edhe testin e shtatzënisë në foto. Bukuroshja Ami, pavarësisht dhënies së këtij lajmi kaq të bukur, nuk ka hezituar edhe të zbulojë gjininë e bebës që pret. Joeli i vogël, do të bëhet së shpejti me një motër. Pavarësisht të gjithave, Ami nuk harron të postojë në "Instagram" çaste nga puna e saj dhe udhëtimet e punës së bashku me Ermalin. Mesa duket, ajo ka zgjedhur të mos rrijë duarkryq e të shijojë shtatzëninë në shtëpi, por ta

Nga Floriana Garo te Zajmina Vasjari, bukuroshet seksi nën nurin e "pritjes së ëmbël"



kalojë atë duke u marrë me atë që parapëlqen më tepër. Nuk janë të shumta fotot që ajo poston, por në foton e fundit ajo duket shumë tërheqëse, një mama vërtet sharmante.

ZAJMINA VASJARI

Këngëtarja superseksi, Zajmina, para pak kohësh zbuloi se ishte shtatzënë, por ndryshe nga VIP-at e tjerë, nuk preferoi ta pranonte lajmin e përhapur nëpër portale. Më vonë, si fare pa dashje, u mësua se Zajmina ishte në muajin e gjashtë të shtatzënisë. Të ftuara në "Pop Culture" të TCH, Jonida Aliçkolli dhe Elona

Duro, dy moderatorët e njohura të Top Albanias, kanë zbuluar pa dashje se Zajmina është në muajin e gjashtë të shtatzënisë. Elona Duro, gjatë rrëfimit për shtatzëninë e saj, për një moment zbuloi: Edhe Zajmina është në muajin e 6-të apo jo?, - pyeti ajo si me dyshim, por u kuptua. Edhe pak muaj dhe Zajmina do të gëzojë statusin e nënës për herë të parë, ashtu si edhe moderatorja Duro. Pas zbulimit të një lajmi të tillë, ajo nuk hezitoi të postonte në faqen e saj në "Instagram" foto ku shfaqej me fustanet e saj të dyqanit dhe ku dukej

një mami vërtet seksi në muajin e gjashtë të shtatzënisë. Ndërkohë që në një foto tjetër ajo shfaqet e veshur me taka në një vizitë te gjinekologu që do ta ndjekë gjatë shtatzënisë. Një veshje paksa e "guximshme" kjo për Zain, e cila, pavarësisht pritjes së ëmbël, nuk heq dorë nga stili i saj i të veshurit. Ndërkohë një tjetër postim bëri përshkrim për ndjekësit e saj. Në një video ajo shfaqet e veshur sport, me barkun jashtë duke kërcyer. Në mbishkrim, Zai ka thënë se kjo është mënyra se si do të mësojë fëmijën e saj të kërcëjë. Një mami vërtet e veçantë Zai, ka zgjedhur të

ketë një shtatzëni aktive dhe sipas stilit të saj.

EDITA SAHITI

Lajmin e bukur që gruaja e Valdrin Sahiti, stilistit më të famshëm kosovar, ishte shtatzënë, e dha vetë ai. Pas martesës madhështore me bukuroshen, Vali nuk duroi dot pa zbuluar edhe surprizën e të bërit së shpejti baba. Një muaj më parë, stilisti Valdrin Sahiti kurorëzoi dashurinë e tij me Editën në një ceremoni intime madhështore në Las Vegas. Pak ditë pas dasmës filluan të qarkullojnë fjalë se Edita ishte shtatzënë. Pikërisht këtë vetëm një muajsh shtatzënë dhe me pak llogari, ne për të ekziston mundësia që gjithçka të ketë ndodhur natën e parë të martesës. Nëna e Valdrinit është shumë e lumtur për foshnjën që do të vijë në jetë dhe po u qëndron pranë me këshillat që vetëm ajo mund t'u japë.

LOLITA BEGOLLI

Një tjetër nuse fatlume, e cila është në një pritje të ëmbël është edhe nusja e këngëtarit të njohur të NRG band, Besnik Qaka. Ai pasi kurorëzoi martesën me bukuroshen Lolita këtë muaj, në një postim në llogarinë e tij i ka kushtuar fjalë zemre bashkëshortes, me të cilën kurorëzoi dashurinë. Sipas burimeve të afërta të çiftit mësohet se ata po presin fëmijën e tyre të parë. Dysheja në fotografinë e fundit që shpërndanë pas dasmës, duken më të lumtur se kurë së bashku në natyrë.

QËNDRESA GASHI

Një tjetër bukuroshe është në pritje të fëmijës së saj të parë. Po flasin pikërisht për gruan e prezantuesit Kosovar Labinot Gashi. Edhe ata, si shumë çiftë të tjera VIP, kurorëzuan dashurinë e tyre këtë muaj të vjeshtës. Ndërkohë që ditë më parë, Qëndresa, ashtu siç e do tradita ka organizuar festën e saj të beqarisë. Qëndresa kishte publikuar imazhe të shumta ku duket se kishte shijuar shumë festat e saj. Mirëpo, në njërin nga imazhet që ka publikuar nga "nata e beqarisë", bie në sy barku i saj më i fryrë. Kjo gjë ka bërë që fansat të dyshojnë për një shtatzëni të mundshme. Dhe më vonë, pas dasmës u konfirmua një lajm i tillë. Edhe Labi së shpejti do të bëhet baba. Një tjetër VIP në pritje të fëmijës së parë!

Oni Hysenbelliu

sjell në Shqipëri seks simbolin Pamela Anderson, jeta dhe pasionet e biznesmenit

Fatmir Hysenbelliu është një ndër biznesmenët më të rinj në Shqipëri. Edhe pse 25 vjeç ai është shumë i suksesshëm, kjo edhe falë bizneseve që babai i tij ka ndërtuar në vite. Fatmiri, ose siç njihet ndryshe Oni është bërë mjaft i njohur edhe në rrjetet sociale, pasi aty tregon projektet e tij, por edhe jetën luksoze që bën. Të jetuarit mes luksit i ka mundësuar atij të udhëtojë e të njohë botën, por jo vetëm kaq. Oni ka takuar personazhe të njohur, si Pamela Anderson apo Nicole Scherzinger. Madje në portale kanë qarkulluar disa foto dyshese të tij duke dalë nga një hotel me yllin e kinemasë Pamela Anderson në Miami, të cilat na vënë në dyshime se kishte një lidhje mes tyre. Dje, Oni ka qenë i ftuar tek emisioni "Rudina" në "Tv Klan", ku ka sqaruar një herë e mirë këtë marrëdhënie dhe gjithë pikëpyetjet e ngritura në raport me bukurshen. "Unë kam qenë në një eveniment bamirësie, që më ka ftuar Pamela. Nuk jam ftuar direkt nga ajo, por organizatorët kanë ftuar njerëzit më me influencë në vende të ndryshme të botës. Unë kam rastisur ulur pranë saj në tavolinë, dhe aty kemi folur dhe kemi krijuar kontaktet. Rastësisht sërish, të dy ishim në të njëjtin hotel dhe fotot që janë shprehur nuk tregojnë asnjë lidhje që është menduar mes nesh. Unë Pamelën e kam mikeshë dhe asgjë më shumë", -ka sqaruar një herë mirë Oni. Së fundi, ai ka treguar, gjithashtu, se do ta ftojë Pamelën në Shqipëri, në një festë të madhe që do organizojë së shpejti.

JETA E BIZNESMENIT

Nga Londra në Rusi, pastaj sërish në Tiranë. Udhëtime pa fund, jetë luksi e angazhime që e kanë kthyer në një nga personazhet më të klikuar në rrjetet sociale. Po flasim për ish-futbollistin e Kombëtares shqiptare, Fatmir Hysenbelliu, që tashmë duket se është fokusuar tërësisht tek bota e biznesit, duke ecur kështu në gjurmët e të atit, biznesmenit të suksesshëm, Irfan Hysenbelliu.

"Kam lindur në një familje biznesmenësh, që të jesh i tillë mëson shumë nga familja. Unë e kuptova që e kisha në gjak. Më pëlqen të merrem me biznes, jam nga ata tipa që nuk mund të bëj gjëra që s'më pëlqejnë", -tha ai në studion e emisionit "Rudina".

Sa për marrëdhënien me të atin biznesmen, Fatmiri shprehet se s'mund të kishte shok më të mirë në jetë. "Jemi si shokë, më besoni. Unë vërtet e kam të tillë



marrëdhënien me tim at, sa ndonjëherë me bën të mendoj nëse vërtet është babai apo shoku im", - thotë ai.

Në një rrëfim të veçantë, 25-vjeçari tregon të gjitha pasionet e tij, që nga makinat e edicioneve të limituara, koleksionin e orave të shtrenjta, futbollin e së fundmi biznesin, gjëra për të cilat u pikas pak kohë më parë edhe nga gazetari i famshëm italian, Enrico Lucci. "Nuk e kam problem të tregoj jetën që bëj, kur gjithçka kemi arritur, e kemi me mund. Jam i mendimit që kur ta mban xhepi, pse jo mund edhe të shpenzosh", - thotë ai me sinqeritet.

Ai foli ndër të tjera edhe për shkepuitjen nga futbollit profesionist. "Unë akoma luaj, futbollit mbetet pasion. Erdha në Shqipëri për një periudhë të shkurtër, mbarova universitetin dhe me pas fokusova tek biznesi, kështu gradualisht mu desh të shkeputesem nga futbollit profesionist. Jam i mendimit: Ose bëj diçka mirë ose mos e bëj hiç, dhe dua të shtoj se cikli i futbollit për mua mbaroi me kaq", - shtoi ai.

Por përveç udhëtimeve, bizne-

sit, sportit dhe stërvitjes, Fatmiri, apo Oni siç e njohin shumica e të rinjve merret edhe me bamirësi. "Nuk jam nga ata tipa që i postoj në rrjetet sociale me foto gjithë të mirat që bëj", -tha ai me modesti.

E përveç këtyre, Oni foli për herë të parë për një aksident në të cilin ishte përfshirë dhe dha një mesazh për të gjithë të rinjtë. "Më ndodhi një aksident kur erdha nga Italia sapo kisha firmo-



sur me Tiranën. Isha pak me shpejtësi, por një makinë tjetër hyri me të kuqe, për ta shmanhur u detyrova të përplasem me një pallat. Nuk është puna sa e sigurt është makina por, ti nuk e di ç'të pret përpara, prandaj iu them gjithë të rinjve të tregohen sa më të kujdesshëm".

Rrëfhet modelja: Familja është qetësia dhe ilaçi i shpirtit për mua

Xheni Bushi: Ju rrëfej vështirësitë që ka modelingu në Shqipëri

“Pse nuk flas për jetën private”

Egla Xhemali

Atë jemi mësuar t'a shohim nëpër kopertinat e revistave më të njohura, në klipe dhe duke pozuar para aparatit fotografik si fotomodele. Xheni Bushi vjen në një rrëfim ekskluziv për suplementin “Bluetooth” të “Gazeta shqiptare”. Bukuroshja na tregon për momentin dhe ndjesitë e para kur ka bërë foto profesionale, për bukuritë e vështirësitë e modelingut. Na zbuloi detaje nga ftesa për t'u bërë pjesë e klipit “Bitchi Mesnatës”, si dhe na foli për lidhjen me familjen. Ajo thotë se e do shumë atë që bën e në këtë mënyrë ka arritur t'ia dalë mbanë gjithçkaje. Xheni pohon se e harron pjesën e vështirësisë dhe sheh vetëm të bukurën që i sjell puna. Sa i përket ftesës për të marrë pjesë në klipin e Alban Ramosajt, fotomodelja na tregon se gjithçka ka ndodhur rastësisht. Bushi nuk e përjashton mundësinë që në të ardhmen mund t'a shohim edhe në pasarella. E pyetur për lidhjen që ka me familjen, Xheni na rrëfen se ata janë të vetmit që i falin qetësi. Bukuroshja ka shumë plane për të ardhmen, na mbetet vetëm të presim që t'i zbulojmë ato.

Si je ndjerë në momentin kur ke bërë foton e parë profesionale?

Të them të drejtën, nuk kam fjalë t'a përshkruaj ndjesinë e asaj dite. Mund të them që një dëshirë e imja që e vogël, ndjeva që u bë realitet.

Sa e vështirë është të jesh fotomodel?

Çdo gjë ka vështirësinë e saj, por nëse me të vërtetë dëshiron të jesh pjesë e modelingut, atëherë do dish t'ia dalësh mbanë.

A je e detyruar të mbash dietë?

Fatmirësisht unë nuk vuaj nga kjo pjesë, sepse sado ha, nuk shtoj në peshë. (qesh)

Mendon se ka moshë ky profesion?

Patjetër që ka edhe moshë, sepse shohim që çdo ditë po dalin fytyra të reja e të bukura.

Modelingu është po aq i bukur, sa edhe i vështirë. Ti vetë ku e sheh të bukurën dhe të vështirën?

Modelingu ka të bukurën dhe të vështirën, por unë personalisht e harroj pjesën e vështirësisë kur shoh të bukurën që më sjell.

Ndërkaq, të gjithë e njohin Xhenin si fotomodel, për çfarë studion?

Unë momentalisht studioj Infermierin të Përgjithshme. E di që do duket e çuditshme, pasi ndoshta nuk ka të bëjë me modelingun, por s'i dihet, do më duhet më vonë në të ardhmen.

Kush është fotografi shqiptar më i mirë?

Unë jam fotografuar nga Endrit Mërtiri dhe për mua ai është më i miri.

Je pjesë e videoklipit të fundit të Alban Ramosajt, si të erdhi ftesa? Njiheshe më parë me të?


Me Albanin kishte pak kohë që njiheshim dhe pjesa e ftesës ndodhi rastësisht. Ai ishte në kërkim të një vajze, e cila mund të luante rolin që kisha unë në klip dhe vendosi të ma besonte mua. Besoj se e ia kam dalë mbanë më së miri.

Në qoftë se do e ndalje kohën, cilin set do të doje të përsërisje?

Çdo set është i veçantë për mua dhe nuk dua të diferencoj ndonjërin prej tyre, pasi secili ka të veçantat dhe bukurinë e veta.

Xhenin do e shohim vetëm para objektivit, apo edhe në pasarella?

Të ardhmes nuk i dihet asnjëherë, gjithçka mund të ndodh. Mund të më shihni si para objektivit, ashtu edhe në pasarella. Do ia lëmë kohës.



Ndihesh më mirë kur të thonë je simpatike apo inteligjente?

Të jesh e bukur dhe të jesh inteligjente janë dy gjëra komplet të kundërta. Mendoj se bukuria pa zgjuarsinë është diçka boshe. Kështu që ndihem më mirë kur cilësohem si një vajzë inteligjente.

Sa e lidhur je me familjen?

Familja për mua është gjëja më e shenjtë që mund të ekzistojë në botë. Me familjen jam shumë e lidhur, janë e vetmja gjë ku gjej qetësi. Janë ilaç i shpirtit për mua.

A është në një lidhje dashurie Xheni?

A jam në një lidhje dashurie?! Preferoj që jetën private ta lë ashtu siç quhet, “private”.

Cilat janë planet e tua për të ardhmen?

Planet e mia për të ardhmen janë të shumta, por do i zbulojmë më vonë.



Kush është biznesmeni nga Durrësi, që i ka rrëmbyer zemrën bukuroshes shqiptare

Tashmë ata janë së bashku prej plot 13 vitesh, edhe pse vitin që shkoi u duk se do të mbyllej me kaq, por vetëm pak muaj më vonë Zaimina Vasjari mori propozimin më romantik për martesë, pikërisht në Maldive, dhe kështu historia e çiftit vazhdoi. Ndërkohë që sot këngëtarja është në pritje të fëmijës së parë me partnerin e saj, të cilin nuk e ka bërë asnjëherë publik, por prej kohësh flitet se është biznesmeni Klodian Asllani, me të cilin ka edhe foto, të bëra nga paparacët, të cilat qarkullojnë në rrjetet sociale. Por, siç kuptohet nga disa foto në profilin e "Instagramit", të Klodianit dhe komentet pasuese, ai është baba i një vajze. Një ditë më parë në "Instastory", ai ka publikuar një foto me një vajzë në krah, të cilin e uron për ditëlindje, dhe mendohet se është e bija, por pak me rritur nga fotoja e mëparshme në "Instagram". Nga çfarë mund të shihet, Zaimina nuk fshihet shumë nga profili i tij, duke mos ia kursyer "like" në thuajse të gjitha fotot e tij. Ndërkohë sa i takon jetës së tij dhe familjes së mëparshme, mësohet se biznesmeni është i divorcuar prej kohësh dhe ka nisur një jetë të re përkrahë këngëtares seksi, Zaimina Vasjari. Mësohet se Asllani merret me një sërë sipërmarrjesh duke filluar nga konstruksionet e çelikut e deri te pasuritë e patundshme. Gjithashtu, sipas disa kërkimeve, duke u bazuar në të dhënat që dyshja kanë në rrjetet sociale, ata kanë plot 10 vite diferencë në moshë. Klodi-


Zbulohet jeta e mëparshme e partnerit të Zaiminës

Babai i një vajze dhe marrëdhënia 13-vjeçare me seksbombën brune



ani është i lindur në vitin 1977 kurse Zaimina 1987. Ndërkohë që Zai pritet të sjellë në jetë shumë shpejt fëmijën e saj të parë. Këngëtarja e njohur vetëm para pak kohësh ka pranuar lajmin se do të bëhet nënë për herë të parë. Ajo do të sjellë në jetë një vajzë duke e bërë partnerin e saj, Klodianin, baba të një vajze të dytë. Edhe pse shtatzënë, bukuroshja seksi nuk ka ngurruar të postojë në rrjetet sociale pjesë nga momentet e ditëve që kalon në pritjen e ëmbël, por në foto mungon gjithnjë partneri i saj, duke vazhduar të jetë e rezervuar për jetën private. Tashmë duke lidhja e tyre duket më se e konsoliduar, dhe pas lindjes së vogëlushes, pritet një martesë madhështore.





"Postimet e Xhenit në "Instastory" u kanë dhënë shkak njerëzve të flasin"

Çifti i 'BB9' i jep fund, flet Bernardi: Ja arsyeja e debatit tonë



Shoh një burrë, një burrë tjetër, edhe një tjetër. 3ëj shaka, nuk ka kaq shumë burra në ditët e sotme.



La mia vita è come una commedia romantica, solo che non c'è romanticismo e l'unica cosa che fa ridere è la mia disperazione

A ta janë një nga çiftet më të njohur të real ity show-t shqiptar, "Big Brother 9", të cilët prej më shumë se një jave na kanë mbajtur pezull nëse do të vazhdojnë së bashku si çift apo do të ndahen. Në fakt, gjatë kësaj jave, Xheni dhe Bernardi nuk kanë publikuar asnjë foto së bashku, ndërsa Bernardi edhe postimet e tjera i ka pasur në numër të kufizuar. Por nga ana tjetër, Xheni nuk harron ta "thumbojë" në një farë mënyre me anën e postimeve të saj ku duket zemërthyer dhe të cilat duket se i referohen Bernardit. Ndërkohë që djali nga Laçi, u shpreh se po kalonin një krizë në çift dhe nuk i dihet se çfarë do të ndodhte më pas. Nga ana tjetër është Xheni, e cila duket më e pikëlluara dhe e mërzitura për këtë situatë që po kalojnë, gjykuar edhe nga postimet e saj në rrjete sociale. E kontaktuar për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare", Xheni nuk ka preferuar të flasë për momentin duke thënë se është vetëm një zënkë, e cila do të kalojë. Nga ana tjetër, Bernardi në një prononcim për "Bluetooth" të "Gazeta Shqiptare" e mendonte njësoj si Xheni situatën e krijuar duke shtuar se për shkak të disa postimeve, për faj të saj, janë ngritur shumë fjalë e zëra lidhur me marrëdhënien e tyre në çift.

Çfarë mund të më thuash për gjendjen e krijuar midis jush?

Ato gjëra që janë publikuar, janë publikuar për faj të Xhenit, një italisht e një anglisht para një jave në "Instastory". Nga këto postime njerëzit kanë gjetur shkak dhe kanë nisur të flasin.

Ju jeni zënë apo jeni ndarë përfundimisht?

Pamela Aliaj

Ne jemi zënë. Për t'u ndarë, kjo ende s'dihet.

A jeni munduar të pajtoheni, meqë është veçse një zënkë?

Përçapje janë bërë, por ende vazhdojmë të zënë.

Ju jeni një çift që konkurroni në "Dance with me", duke qenë se jeni të zënë, e keni problem që kërceni bashkë, duke qenë se dhe aty nuk dukeni se keni hatërbetje ndaj njëri-tjetrit?

Po normal që nuk do sillemi si të zënë. Se s'duhet të duket asnjë nga ne arrogant e të mbajë mëri. Respektojmë formatin televiziv. Ne jemi të zënë jo të ndarë. Po të ishim të ndarë do të kishim më siklet.

Nuk e keni problem që kërceni bashkë edhe pse të zënë?

Problem është pak. Përdërisa je i zënë dhe kërcen e rri prapë me të, ka pak problem.

Megjithatë në orët e vona të mbrëmjes që lamë pas ajo ka publikuar një tjetër thënie në "Instastories" që na bën të mendojmë se "stuhia" ka kaluar. "Ndaheshim të paktën njëherë në javë, "përgjithmonë", pastaj nuk e dinim si arrinim të bënim paqe përsëri," shkruhet në foton e publikuar nga Xheni, ndërkohë që ajo e ka shoqëruar me një emoji në zemër. Ende nuk dihet nëse çifti i ka dhënë fund zënkës së tyre dhe janë pajtuar. Megjithatë duket se gjithçka mbetet për t'u parë në mbrëmjen e kësaj të hëne në show-n "Dance with me". Urojmë që çifti t'i ketë dhënë fund një zënkë të filluar për më shumë se një javë dhe të rikthehen të dashuruar si më parë.



● Të zënë, por kërcëjnë bashkë në "Dance with me". Ju tregoj 'prapaskenat e show-t televiziv'. ●

Opinion *i* Ditës

Nga Arian Galdini

(Vijon nga faqja e parë)

... i Komisionit të Venecias, z. Gianni Buquicchio.

E shkruaj me bindje këtë gjë, sepse kam lexuar, kërkuar e pyetur shumë.

Në ditët e sotme, vetë BE dhe vendet anëtare të BE kanë një fuqizim të modeleve politike dhe korporative, më shumë sesa personaliteteve të doktrinave, bindjeve dhe përvojës së drejtpërdrejtë në Drejtësi.

Gjykatës dhe prokurorë të niveleve të epërme po zgjidhen gjithnjë e më tepër "lojtarët e preferuar të korporatave, grupeve të interesit dhe politikanëve".

Mund të lexojmë pafund artikuj, debate dhe studime mbi këtë fenomen. Pafund.

Gianni është një nga të paktët e mbijetuar si zotërues, ushtrues dhe besimtar doktrine dhe bindjesh të qarta.

Për këtë, them se është një fat i madh për Shqipërinë që ka një mik kaq nderuar e kaq të dashuruar me vendin tonë.

Prej shumë e shumë vitesh, Giannin e kanë ndërlidhur punët me Shqipërinë, por edhe shumë miq që ai ka bërë këtu.

Së fundmi ai ishte përsëri në Tiranë, ku edhe bëri një deklaratë të fortë e të drejtpërdrejtë, në të cilën pak a shumë shprehej se Shqipëria është e zhytur në korrupsion dhe krim...

Nuk e di pse, por ndërsa lexoja deklaratën e tij, m'u krijua përshtypja se sado e fortë të duket ajo, ka gjithsesi romantikën e qytetit ku punon e ndoshta frymëzohet Gianni.

Venecia është e zhytur. Venecia ka madhësinë e tmerrit të ndërtesave që ngadhënjëjnë e ngrihen mbi ujën e detit, e që madje janë aq të bukura sa të magjepsin.

Shqipëria ta vret imagjinatën. Asgjë nuk qëndron përmbi, këtu.

Kur dikush e sheh këtë vend të zhytur, bën 2 gabime bazë, por të fanepsura prej dëshirës së mirë.

Së pari, me zhytje lënë të kuptohet se ose ka një vullnet nga vetë vendi për t'u kredhur, ose forcat madhore e kanë ndëshkuar.

Së dyti, me zhytje nënkuptojnë edhe daljen përmbi. Nuk ka zhytje pa kredhje, e nuk ka kredhje pa dalje përmbi. Këtë mund ta klasifikojmë edhe si inkurajim.

Por jo.

Askush që flet për zhytje, madje as vetë Gianni, nuk kanë të drejtë.

Gianni, Shqipëria nuk është e zhytur, por e mbytur!



Shqipëria është e mbytur nga krimi dhe korrupsioni. Kjo është e vërteta e hidhur dhe dëshpëruese.

E kanë mbytur pa pikën e mëshirës ata që e kanë qeverisur në 105 vjet shtet shqiptar.

Ata që kanë qenë në krye të punëve të këtij vendi, kanë pasur gjithmonë vesin, mendjengushtësinë dhe shpirtligësinë e bërjes plaçkë dhe grumbullimit të sa më shumë pushteteve pranë e rreth vetes.

Kur nuk u ka mjaftuar shteti, janë shitur tek të huajt, kur nuk u kanë mjaftuar as të huajt, janë shitur tek krimi dhe mafia.

S'kanë lënë gjë pa bërë për të qenë në pushtet a me pushtet.

Shteti për ta ka qenë pllaja a shpella e çetës së komitëve, prej nga ku bënin planet e plaçkitjes e ku fshiheshin që të mos kapeshin.

Shteti nuk ka qenë kurrë për këta, një ide e madhe, një vizion, një pasion e ideal për të cilin mund të sakrifikohet e mira personale e madje edhe vetja.

Jo. Shtetin dhe pushtetet i kanë parë si hapësira dhe vegla perversitetesh dhe nginjsh personale.

Prandaj edhe e kanë mbytur këtë vend. Sepse i mbytur u vlen si relike, si ekzotikë, si strehë piraterie moderne.

Janë aty si varkëtarët që edhe për ta çuar vendin e tyre në Ha-

des, i kërkojnë dy monedhat në sytë e mbyllur dhe fytyrën e pafrymë.

E kanë mbytur këtë vend këta, i dashur Gianni.

E kanë mbytur dhe janë kujdesur t'ia lidhin trupin me tonelata kanabis që të mos ketë kurrë fuqi e mundësi të dalë mbi ujë.

Janë kujdesur që gjymtyrët t'ia lidhin me gurë të rëndë krimi dhe hajnie, ndërsa si kostum përcjelljeje i kanë veshur një tuftë me kaqolla, kokëboshë, trutharë, trushpëlarë e batakcinj, të cilët i kanë bërë deputetë e ofiqarë.

Të merituarve u kanë lënë si shans ose heshtjen e dorëzimit, ose sikterisjen nga ky vend.

Të zotëve, të talentuarve, të ndershmëve, njerëzve me integritet u kanë lënë si shpresë vetëm muajin tetor të çdo viti, kur vjen koha e aplikimit për lotarinë amerikane.

Nuk ka veting e reformë në drejtësi që e nxjerr mbi ujë këtë vend të mbytur në krim, hajni e batërdi.

Vetëm një mrekulli nga Qiejt ose një rijetësim i trupit të vendit nga një revolucion i ndritur, nga një zgjim i madh kombëtar mund të na nxjerrë përmbi.

Përndryshe, vendin e mbytur do ta braktisim të gjithë.

Me keqardhje mik, por kështu e mendoj.



BLUE TOOTH

THASHETHEME
MADE IN
ALBANIA



te rejat
nga jeta
ipave

Çdo të shtunë falas me

PARTIZANI



Tri fitore radhazi dhe shpresa për të mos u ndalur as këtë javë përballë, ndonëse Mark Juliano ka probleme në sulm dhe në mbrojtje. Partizani pret të dielën Flamurtarin e vendit të tretë. Ekipi i Duros është një rival i fortë dhe kryeqytetasit duhet të japin më shumë sesa ndeshja në "Loro Boriçi" për të mbajtur hapin e trepikësheve. Gjithsesi Julianos do t'i duhet që edhe ndaj vlonjatëve të bëjë pa Sukajn e Çanin,

Juliano i var shpresat te Milan Basrak

ndërsa peshën e sulmit do ta mbajë Milan Basrak. Serbigje-ti golin e tij të parë ndaj Vllaznisë dhe në ndeshjen e fundit të kontrollit është shfaqur shumë mirë, teksa drejtuesit e kuq shpresojnë që Basrak të ruajë impaktin e ndeshjes së parë. Në mbrojtje Kalari dhe Malota shfaqën probleme në

90 minutëshin e Shkodrës, por shpresohet që të dy të jenë gati në fundjavë. Pjesa tjetër e ekipit shfaqet e plotë, ndërsa prej disa ditësh drejtuesit e kuq po bluanë në mendje aktivimin e kartës "asani". Anësori i talentuar ka shënuar pafund me Partizanin B, ndërsa në testin e së

enjtës ishte sërish protagonist, duke marrë dhe vlerësimet maksimale të trajnerit Juliano. Gjithsesi, skuadra titullare pak pritet të ndryshojë nga ajo itali-ani rreshtoi në "Loro Boriçi", ndërsa në "Selman Stërmasi", Partizani do të përkuptet të ruajë hapin e Skënderbeut dhe Kukësit, ndërsa në rast triumfi, do t'u rrrëmbente pikërisht vendin e parë kuqezinjve të Shpëtim Duros.

Serbi beson se me riaftësimin e të dëmtuarve, kampionët do rigjejnë lojërat e mira

Milinkoviç: Respekt për Gjokën, por fitoj unë

Trajneri i Kukësit kërkon 3 pikët të dielën



Jeton Selimi

Mladen Milinkoviç përballë Ernest Gjokës, trajnerit që shpalli për herë të parë Kukësin kampion të Shqipërisë. Asgjë personale, përkundrazi, trajneri serb e konsideron kreun e stollit të Vllaznisë një koleg të suksesshëm, që do të synojë të bëjë diçka të mirë edhe te "kuqebllutë". "Nuk shoh të kem sfida me Gjokën. E konsideroj si një koleg të suksesshëm, që vjet bëri gjithçka mirë dhe doli kampion. Gjoka do të kërkojë të bëjë diçka të mirë edhe me Vllazninë dhe të tregojë se është trajner i suksesshëm. Edhe kundër Luftëtarit dhe ndaj Vllaznisë përballimi në një moment kur kundërshtarët kanë ndërruar trajnerët. Ne do të kërkojmë të marrim maksimumin, siç ia dolëm në Gjirokastrë." Gjoka vlerësohet shumë nga tifozët verilindorë, por

SUPERLIGA	
JAVA E 8-të	
TË SHTUNËN	
Lushnja - Teuta	14:00
Skënderbeu-Luftëtari	17:00
TË DIELEN	
Kukësi - Vllaznia	14:00
Partizani - Flamurtari	17:00
TË HËNËN	
Kamza - Laçi	14:00

Milinoviç është i bindur që në "Zeqir Ymeri", përtej respektit për teknikun kundërshtar, do të mbështesin Kukësin. "Për mua rëndësi ka të fitojmë ndeshjen. Siç më mirëpritën në Gjirokastrë, ashtu do ta mirëpresin edhe Gjokën në Kukës. Por jam i



sigurt që tifozët do të mbështesin skuadrën tonë. Vllaznia është një ekip që luan futboll pa ndrojtje dhe kërkon pikë. Me gjithë respektin që kemi, do të luajmë futboll të bukur dhe do të marrim fitoren.

Nuk e di nëse do të luajë Sh-tubina, nëse do ta shohim në nevojshme, do ta hedhim në fushë." Milinkovic shpjegoi më tej se luhatjet e vazhdueshme në lojën e Kukësit

lidhen vetëm me mungesat e shumta në skuadër. "Kemi shumë luhatje në lojë edhe për shkak të lojtarëve të dëmtuar. Kur të riaftësohen të gjithë, besoj se do ta minimizojmë këtë defekt. Ka shumë rëndësi të paraqitemi sa më mirë dhe të grumbullojmë sa më shumë pikë deri në fund të vitit." A pret trajneri i Kukësit një "dhuratë" nga ish-skuadra e tij, Luftëtari, që luan në transfertë me Skënderbeun? "Lojtarëve u kam thënë që e rëndësishme është të bëjmë punën tonë. Nëse ndonjë ekip tjetër ndal Skënderbeun apo rivalët tanë të tjerë, aq më mirë për ne. Nëse nuk marrim pikët në ndeshjet tona, s'mund të pretendojmë të përfitojmë nga ndalesa e rivalëve."

TRAJNERI I ÇELSIT

Konte i ka ditët e numëruara, Abrahmoviç

zgjedh Ançelotin

Karlo Ançeloti është kandidati kryesor për stolin e Çelsit, në rast të një shkarkimi të Antonio Kontes. E ardhmja e ish-trajnerit të Kombëtares së Italisë vijon të jetë e varur në fije të perit, për shkak të mosmarrëveshjeve të vazhdueshme me drejtuesit londinezë. Ndaj nuk përjashtohet që marrëdhënia mes tyre të ndërpritet ende pa u mbyllur sezoni aktual. Në një rast të tillë, sipas The San, rikthimi i Ançelotit në "Stamford Bridge" do të ishte hipoteza më e pranueshme. Raportet gjithnjë të tendosura me Konten, po e shtyjnë Abrahmoviçin që të shikojë përfaqë dhe manjati rus ka gjetur tek Ançeloti njeriun e duhur në rast se gjërat me trajnerin nga Salento do të përqeshoheshin në javët e ardhshme. Karleto në Londër do të rikthehej pas transitit të viteve 2009-2011, dy sezone ku në të parën pati sukses dhe në të dytën dështoi. Në sezonin e parë trajneri nga Rexholo fitoi Komjuniti shield, Premier Ligën dhe FA Kap, duke u bërë trajneri i parë në historinë e bluve që siguron kaq tituj në një sezon të vetëm. Një vit triumfues me një të metë të vetme, eliminimin në një të tetat e Ligës së Kampioneve nga Interi i Murinjos. Keq viti i dytë, që u mbyll me vendin e dytë në kampionat dhe eliminimin në çerekfinale të Championsit nga Manchester Junajtid. Ançeloti u shkarkua nga Abrahmoviç në fund të sezonit pasi dështoi në Champions, që ishte dhe objektivi parësor i Abramoviçit, por gjithsesi në Londër ai la një kujtim të mirë.

TRAJNERI I SKËNDERBEUT

Skënderbeu do të presë Luftëtarin e Gjirokastrës në takimin që do të zhvillohet të shtunën në orën 17:00 në Korçë. Trajneri Ilir Daja sheh me kënaqësi që grupi i tij i lojtarëve e ka përballuar me sukses ngjeshjen e ndeshjeve që kanë pasur në kalendar mes kampionatit dhe Europa Ligës. Pavarësisht se lojtarët nuk janë në maksimumin e tyre për shkak të mbingarkesës, Daja pret nga ata sakrificon e radhës. "Kemi kohë që luajmë me këtë intensitet ndeshjes. Nuk e kemi pasur gjithë grupin në dispozicion, por e rëndësishme është që në vazhdim do na kthehen disa lojtarë. Me Luftëtarin do të luajmë lojtarët më cilësorë, pasi kampionati

Daja: E mposhtim Luftëtarin, nuk më interesojnë rivalët



është objektivi ynë. Skënderbeu luan gjithmonë për fitore, por në lojë janë në 3 rezultatet. Kur luajmë me dëshirë, marrim pikët maksimale dhe këtë do të bëjmë dhe nesër (sot)". Në fund teknikun kryeqytetas lëshon thumba ndaj rivalëve, duke thënë se rezultatet e tyre nuk i interesojnë për sa kohë ekipi i tij mban ritmin e fitoreve.


"Nuk dua të bëj krahasime me kolegët. Kemi lojtarë me cilësi të mira dhe ritëm. Duam të vazhdojmë me këtë nivel dhe këtë ritëm për të arritur objektivin. Duhet t'i imponojmë kundërshtarit lojën tonë. Titulli është objektivi i arritshëm. Besoj se lojtarët që kam në dispozicion, pasi shoh që ata janë të motivuar për të fituar".

KAMZA

Ndreu: Ndaj Laçit do të jetë një lojë burrërore

Kamza pret Laçin të hënën në ndeshjen që do të ulë siparin e fazës së tetë të Superligës. Të besuarit e Ramadan Ndreut do të kërkojnë që të lënë pas zhgënjimin e pësuar në Vlorë, ndërsa vetë trajneri krutan shpreson që lojën e mirë që Kamza shfaqti ndaj Flamurtarit, ta zhvillojë edhe ndaj kurbinasve, ndonëse është i bindur se 90 minutëshi do të jetë vërtet i luftuar për shkak edhe të renditjes në tabelën e klasifikimit, me bardhezinjtë që pozicionohen në vendin e pestë me 10 pikë dhe kamzalinjtë që gjenden të gjashtë me një pikë më pak. "Do të bëjmë çmos që ndeshjen e mirë që zhvilluam në Vlorë ta sjellim edhe ndaj Laçit. Do të jetë një ndeshje e fortë, një lojë burrërore, pasi Laçi ka një ekip të mirë. Gjithsesi në fund besoj se do të fitojmë ne," - deklaroi shkurtimisht për "SportNews". Kamza vjen në këtë përballje pas disfatës së pësuar në Vlorë, ku ndaj Flamurtarit u mposht 1-0, çka i dha fund një ecurie pozitive vërtet mbresëlënëse nga skuadra e rikthyer në këtë edicion në kategorinë e më të mirëve.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- Humanisti i Rotterdamit
- Mund të jenë cigaresh.
- Capirossi i MotoGP.
- Eshhtë bixhoz
- I vetmi në orar.
- Para Diego në Kaliforni.
- Fillojnë sefte.
- Eshhtë makina për guidë.
- Inicialet e Benigni-t.
- Janë riparime.
- Janë të brishtë.
- Fillojnë largimin.
- Ishin kambistë të dikurshëm.
- Një motoskaft gare.
- Kështu thirrej Marco Pantani.
- Janë penjtë për moline.
- Emër vajze.
- Janë edhe ato të cirkut.
- Nuk ka tradhtari.
- Janë baballarët.

VERTIKAL

- Paul që qe poet i famshëm.
- Dennis i McLaren.
- Këndohet në opera.
- Gjysmë siklet.
- Kufijtë e matjes.
- I zhvillon kongresi.
- Inicialet e Moravia-s
- Janë kërërë bandash.
- Të fundit në tender.
- Fund shkurti.
- Mund të jenë grosistë
- Ka shirit magnetik një e tillë.
- Ishin engjejt të korit të lartë
- Janë gjynahet
- Bega komik.
- Janë shemra.
- Inicialet e Morricone-s.
- Janë edhe ato fetare.
- Një gjuajtës francez.
- Gjika e Dora D'Istria-s.
- Qytet grek.
- Bëjnë katrorë me një kat.
- Ishin ndjekësit e Antistenit.
- Shkruhet i treti.
- Një sulm... kardiak.
- Ki Moon i OKB
- Inicialet e Rohmer.
- Robert Mitchum.
- Dy asa.


Fjalëkryqi (2)

HORIZONTAL


- Bëhet një me psonisje.
- Një mund të jetë qeveritar
- Maiden që këndojnë.
- Një ushtarak është solemn.
- Inicialet e Mann shkrimtar nobelist.
- Teket pa kufij.
- Mbetet në fund.
- Një treshe në skenë.
- Një mongol i Timurlengut
- Një peshk i rëndë.
- Tiriac ish-tenist
- Kufizojnë një takim.
- U hodhën në Tartar nga Zeusi
- Fillojnë nazet
- Kalimi në krye.
- Ishtë gruaja që i dha ujë nga pusi Je-zusit.
- Janë portet.
- Dashi kur mungon ai
- Javier, shefi i diplomacisë së BE
- Kufizohet në kufij
- Ente Civile Europiane.

VERTIKAL


- Një birrë.
- Mbetur në fund.
- Ramazozotti këngëtar
- Janë në modë.
- Janë tek në shaka.
- Eshhtë dite në mbledhje.
- Një pjesë e kandidaturve.
- Jessica Parker aktore.
- Inicialet e Presley.
- Akoma është ndryshe.
- Janë brijnjet në skuadër.
- Qendër fitimi
- Brad aktor.
- Komandohet nga gjenerali.
- Në hyrje të zonës
- Janë në skajë
- Janë librat e parë
- Mund të jetë arme.
- Incialet e Turgeniev.
- Ndërmarrje Industriale Tiranë.
- Mund të lakohet.
- Janë araknidet si vejshua e zezë.
- Mund të jetë e lirë në port.
- Një mjet lundimi.
- Shkroi Rinoceronti.
- Ekstremitë në ritëm.
- Kalohen në gjurmë.
- Filmi i parë shqiptar.
- Fillojnë takimet
- Kufizojnë kënde.
- Një depozitë drithi.
- Janë vendet e para.
- Një parabolë e tenistit.
- Eshhtë llogari që qerohet.
- Shteti me Khartum.
- Janë kapot e bandave.
- Një thirje e dëshpëruar nga direku.
- Lidhin brigje.
- Një lidhëz
- King Cole i muzikës.
- Fillojnë ndeshjen.
- Sapo fillojnë.
- Mbetet në fund.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

	6	4				8		5
	7	3		1				6
2	1		9	5				
	8				3	7		
6		7	1		5	3		2
		9	2				4	
				8	9		6	3
4			3			1	7	
8		5				2	9	

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

6	7	3	1	5	4	9	8	2
9	2	5	3	7	8	1	6	4
8	4	1	9	2	6	3	5	7
3	1	4	8	6	9	7	2	5
7	8	9	2	4	5	6	3	1
5	6	2	7	3	1	4	9	8
4	5	7	6	9	2	8	1	3
2	9	8	4	1	3	5	7	6
1	3	6	5	8	7	2	4	9

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

4	2		9	4	1	10		5	10
2	7	8	6		15	3	6	10	3
O	2		8	5	3		9	3	7
K	1		2	3	11	3	4	7	5
A	2	8	11	1	12	8	11	3	13
5	3	6	3	12	8	13	8	1	6
1		7	4	3	13	7	3		6
2	3		8		7	5	1	11	3
7	6		4	1	4	3	13	7	4
11	3	2		16	8	11		9	15
7	4	8	6	8		8	16		8

H	I	J	A		K	S		S	T	O	L
A	N	E	T		D	A	F		H	L	T
B	A	T		H	E	R	E	T	I	K	E
I	T		H	O	N	O	R	A	R	I	T
T		K	A	P	I	T	A	L	I	S	T
O	A	L		K	R	A		T	R	L	
R	E	A		I	O		S	J	I	A	E
E		S		N	A	T	O		T	I	F
	M	I	S	S		P	O	E	T		N
N	I	K	I		M		L		A	M	E
A	N	E	S	T	E	Z	I	S	T	R	A
T	A		B	A	R	A	K	A		I	T

Argëtim filozofik

- "Përpasa se të nishesh për hakmarrje, gërmo dy varre". **Konfuci**
- "Të fuqishëm nuk janë ata që gjithmonë fitojnë, por ata që pavarësisht se sa herë dështojnë, kurrë nuk reshtin së përpjekuri". **Liam Pryne**
- "Kij parasysh se vetëm ai që lufton me errësirën brenda tij, do të ketë nesër e pasnesër një pjesë të tij tek Dielli". **Odissea Eliti**

PËRGJIGJET E FJALËKRYQVE TË NUMRIT TË KALUAR

L	U	I	S	A		K	O	H	A	A	D
P	O	R	T	A		F	A	T	A	L	E
E	S	A		D	L	P					S
N	A	I		P	E	L	I	K	A	N	I
E	L	S	A	B	O	T	I	M	E	T	H
L	A	K	O	N	I	K	E	T	V	E	T
M	O	N	O	T	O	N		V	E	T	E
B	O	L	E	R	O		I	B	E	R	T
S	I	T	A	R		R	R	I	P	A	T
P	B	I	M	E	S	I	A	T	A	A	D
T	R	E	A	T	A	N	A	A	D	A	
N	A	T	A		M	I	A	A	P	E	L

FJALËKRYQI (1)

R	O	W	A	N		B	A	K	A	L	L
A	B	E	L		P	N	A	T	A		R
S	O		E	P	I	T	E	T	T	R	I
A	R	A	T		R	I	T	A	T	T	O
K	I		N	O	T	A	R	E	T	N	A
K	I		A	M	E	R	I	K	A	N	E
E	H		P	A	M		A	D	S	H	
K	O		L	O	N	A		K	T	E	C
T	U	N	E	L	E	T		E	R	O	S
E	R		B	A	I	T		K	E	S	T
T	A		T	I	S	A		R	A	H	E
E	T		J	A		K	A	T	E	T	I

FJALËKRYQI (2)

Thënie të mençura

- Tshjështësia është sofistikimi më i mirë.
- Një ditë e shpenzuar mirë, sjell gjumë lumturie.
- Pengesa më e madhe e njeriut, janë mendimet e tij.
- Jam impresionuar nga veprimi. Të dish nuk është e mjaftueshme; ne duhet të vëmë në zbatim. Të kesh vullnet nuk mjafton; ne duhet të veprojmë.
- Dhimbja e nxit njeriun të mendojë. Mendimi e bën njeriun të mençur. Mençuria e bën jetën të lehtë.
- Për të pasur sukses, dëshira jote për sukses duhet të jetë më e madhe se frika nga dështimi.
- Bill Cosby

www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

GSH

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE



Tashmë edhe lundroni!

